dhëna në Shtojcën I të Kësaj Rregullore apo një emër që ka gjasa të ngatërrohet me to, kjo markë apo ky emër vihet menjëherë përpara ose pas përshkrimeve të përbërjes së fibrave tekstile të përcaktuara në nenet 5, 7, 8 dhe 9 të kësaj Rregullore. Informata të tjera jepen gjithmonë veçmas. 3. Etiketimi ose shënjimi sigurohet në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës apo në gjuhë të tjera që kuptohen lehtësisht nga konsumatorët. Në rastin e bobinave, çikrikëve, torkave, lëmsheve /(shtëllungë fjongoje) apo fijeve që përdoren për qepje, qëndisje dhe riparime aplikohet paragrafin 1 të këtij neni për etiketimin gjithëpërfshirës të referuar në nenin 17 paragrafin 3 të kësaj Rregullore. Në rastet kur këto produkte shiten në mënyrë individuale, ato mund të etiketohen apo shënjohen në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut, me kusht që ato të jenë të emërtuara në mënyrë gjithëpërfshirëse.	liable to be confused therewith, such trade mark or name shall be given immediately before or after the textile fibre composition descriptions referred to in Articles 5, 7, 8 and 9 of this Regulation. Other information shall be always displayed separately. 3. The labelling or marking shall be provided in the official languages of the Republic of Kosovo or other languages that are easily understood by Kosovo consumers. In the case of bobbins, reels, skeins, balls or other small quantities of sewing, mending and embroidery yarns, the paragraph 1 of this article shall apply to the inclusive labelling referred to in Article 17 paragraph 3 of this Regulation. Whenever these products are individually sold, they may be labelled or marked in a language easily understood to the competent market surveillance authorities, provided they are also inclusively labelled.	pravilnika ili naziv koji se može pogrešno protumačiti kao naziv vlakana, takva trgovačka marka ili naziv obavezno se navode neposredno pre ili posle opisa tekstilnog vlakna iz člana 5, 7, 8 i 9 ovog Pravilnika. Ostale informacije uvek se prikazuju odvojeno. 3. Etikete ili oznake navode se na službenom jeziku Republike Kosova ili na drugim jezicima koje potrošači lako razumeju. Za sve vrste namotaka, vitica, klubaka ili neke druge male količine konca za šivanje, krpanje ili vezenje, primenjuje se stav 1. za zajedničko označavanje etiketom iz člana 17 stav 3 ovog Pravilnika. Kada se ovi proizvodi prodaju pojedinačno, mogu biti označeni ili obeleženi na lako razumljivom jeziku za nadležne organe za nadzor nad tržištem, pod uslovom da su označeni na sveobuhvatan način.
---	---	--



Neni 17 Përfshirjet	Article 17 Derogations	Član 17 Izuzeci
1. Rregullat e përcaktuara në nenet 11, 14, 15 dhe 16 të kësaj Rregullore i nënshtrohen përjashtimeve të përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni. 2. Nuk është e domosdoshme të tregohen emrat e fibrave tekstile apo përbërjes së fibrave në etiketat dhe shenjat e produkteve tekstile, të dhëna në Shtojcën V të kësaj Rregullore . Megjithatë, në rastet kur një markë tregtare ose emri i një sipërmarrjeje përmban, më vete apo si rrënjë apo si mbijemër, njërin nga emrat e fibrave tekstile të përcaktuara në Shtojcën I apo një emër që ka gjasa të ngatërrohet me to, zbatohen nenet 11, 14, 15 dhe 16 të kësaj Rregulloreje. 3. Në rastet kur produktet tekstile të përcaktuara në Shtojcën VI të kësaj Rregullore janë të të njëjtit lloj dhe përbërjeje të fibrave, ato mund të vihen në dispozicion në treg së bashku me një etiketë gjithëpërfshirëse.	1. The rules laid down in Articles 11, 14, 15 and 16 of this Regulation shall be subject to the derogations provided for in paragraphs 2, 3 and 4 of this Article. 2. The indication of textile fibre names or fibre composition on the labels and markings of textile products listed in Annex V is not required. However, where a trade mark or name of an undertaking contains, on its own or as a root or as an adjective, one of the names listed in Annex I or a name liable to be confused therewith, Articles 11, 14, 15 and 16 of this Regulation shall apply. 3. Where textile products listed in Annex VI of this Regulation are of the same type and fibre composition, they may be made available on the market together with an inclusive labelling.	1. Pravila propisana članovima 11, 14, 15 i 16 ovog Pravilnika podležu izuzecima predviđenim u stavovima 2, 3 i 4 ovog člana. 2. Nije neophodno navođenje naziva tekstilnih vlakana i sirovinskog sastava na oznakama i etiketama tekstilnih proizvoda iz Priloga V ovog Pravilnika. Međutim, ako trgovačka marka ili naziv privrednog subjekta sadrži kao samostalnu reč, koren reči ili pridev neki od naziva tekstilnih vlakana navedenih u Prilogu 1 ili naziv koji se može pogrešno protumačiti kao naziv naveden u Prilogu 1, primjenjuju se članovi 11, 14, 15 i 16 ovog Pravilnika. 3. Ako tekstilni proizvodi navedeni u Prilogu VI ovog Pravilnika su iste vrste i sirovinskog sastava, na tržište se mogu isporučiti zajedno, sa zajedničkom etiketom.



4. Përbërja e fibrave të produkteve tekstile që shiten me metër mund të jepet tek gjatësia apo topi i metrazhit të vënë në dispozicion në treg. 5. Produktet tekstile, të cilat përcaktohen në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, vihen në dispozicion në treg në mënyrë të tillë që përbërja e fibrave të atyre produkteve t'i bëhet e ditur çdo blerësi në zinxhirin e furnizimit, duke përfshirë konsumatorin. KAPITULLI III MBIKËQYRJA E TREGUT Neni 18 Kontrollet e mbikëqyrjes së tregut 1. Në përputhje me këtë Rregullore, Inspektorati i Tregut kryen kontrolle për përputhshmërinë e përbërjes së fibrave të produkteve tekstile me informatat e dhëna në lidhje me përbërjen e fibrave të këtyre produkteve.	4. The fibre composition of textile products sold by the metre may be shown on the length or roll made available on the market. 5. The textile products referred to in paragraphs 3 and 4 of this Article shall be made available on the market in such a way that the fibre composition of those products is made known to each purchaser in the supply chain, including the consumer. CHAPTER 3 MARKET SURVEILLANCE Article 18 Market surveillance checks 1. The Market Inspectorate shall carry out checks on the conformity of the fibre composition of textile products with the supplied information related to the fibre composition of those products in accordance with this Regulation.	4. Kod tekstilnih proizvoda koji se prodaju na metar, sirovinski sastav označava se po dužini ili obeležava etiketom na kraju svakog namotaja koji se isporučuje na tržište. 5. Tekstilni proizvodi iz st. 3. i 4. ovog člana isporučuju se na tržište tako da je njihov sirovinski sastav dostupan svakom kupcu u lancu isporuke, uključujući i krajnjeg potrošača. POGLAVLJE III NADZOR TRŽIŠTA Član 18 Kontrole tržišnog nadzora 1. U skladu sa ovim Pravilnikom, Tržišna Inspekcija vrši provere kompatibilnosti sastava vlakana tekstilnih proizvoda sa informacijama koje su date u vezi sa sastavom vlakana ovih proizvoda.
--	---	--



2. Operatori ekonomik që shkel detyrimet sipas kësaj Rregullore, do të ndëshkohet sipas Ligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit. Neni 19 Përcaktimi i përbërjes së fibrave 1. Me qëllim të përcaktimit të përbërjes së fibrave të produkteve tekstile, kontrollet e përcaktuara në nenin 18 të kësaj Rregullore kryhen në përputhje me metodat e përcaktuara në Shtojcën VIII ose me standardet e harmonizuara të përcaktuara në atë Shtojcë. 2. Në përcaktimin e përbërjes së fibrave të përcaktuara në nenet 7, 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje, nuk do të merren parasysh artikujt e listuar në Shtojcën VII të kësaj Rregullore. 3. Përbërja e fibrave të përcaktuar në nenet 7, 8 dhe 9 të kësaj Rregullore, përcaktohet duke aplikuar në masën anhidrike të secilës fibër	2. Economic operator who violates the obligations under this Regulation shall be penalized according to the Law on Technical Requirements for Products and Conformity Assessment. Article 19 Determination of fibre composition 1. For the purpose of determining the fibre composition of textile products, the checks referred to in Article 18 of this Regulation shall be carried out in accordance with the methods set out in Annex VIII or with the harmonised standards to be introduced in that Annex. 2. In the determination of fibre compositions set out in Articles 7, 8 and 9 of this Regulation, the items listed in Annex VII shall not be taken into account. 3. The fibre compositions set out in Articles 7, 8 and 9 of this Regulation shall be determined by applying to the anhydrous	2. Ekonomski operater koji krši obaveze prema ovom Pravilniku kazniće se prema Zakonu o Tehničkim Zahtevima za Proizvode i Ocenjivanju Usaglašenosti. Član 19 Određivanje sastava vlakna 1. U cilju utvrđivanja sastava vlakana tekstilnih proizvoda, kontrole predviđene u članu 18 ovog Pravilnika vršiće se u skladu sa metodama navedenim u Prilogu VIII ili usklađenim standardima navedenim u tom Prilogu. 2. Prilikom određivanja sirovinskog sastava iz čl. 8 do 10 ovog pravilnika, ne uzimaju se u obzir komponente tekstilnih proizvoda navedene u Prilogu VII ovog Pravilnika. 3. Sirovinski sastav tekstilnih proizvoda iz čl. 7, 8. i 9. ovog pravilnika određuje se dodavanjem odgovarajućeg dogovorenog
---	---	--



tolerancën e përshtatshme të miratuar që përcaktohet në Shtojcën IX, pas largimit të artikujve të përcaktuar në Shtojcën VII të kësaj Rregullore. 4. Laboratorët përgjegjës për testimin e përzierjeve të tekstilit, për të cilat nuk ka metodë uniforme të analizave në nivel evropian, përcaktojnë përbërjen e fibrave të përzierjeve të tilla, duke paraqitur rezultatet e fituara në raportin e analizave, metodologjinë e përdorur dhe shkallën e saktësisë. Neni 20 Tolerancat 1. Me qëllim të përcaktimit të përbërjes së fibrave të produkteve tekstile, zbatohen tolerancat e përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni. 2. Pa paragjykuar nenin 8 paragrafin 3 të kësaj Rregullore, prania e fibrave të huaja në përbërjen e fibrave që do të ofrohen në përputhje me nenin 9 të kësaj Rregullore nuk ka nevojë të tregohet, në rast se përqindja e	mass of each fibre the appropriate agreed allowance laid down in Annex IX, after having removed the items set out in Annex VII of this Regulation. 4. The laboratories responsible for the testing of textile mixtures for which there is no uniform method of analysis shall determine the fibre composition of such mixtures, indicating in the analysis report the result obtained, the method used and its degree of accuracy. Article 20 Tolerances 1. For the purposes of establishing the fibre composition of textile products, the tolerances laid down in paragraphs 2, 3 and 4 of this Article shall apply. 2. Without prejudice to Article 8 paragraph 3 of this Regulation, the presence of extraneous fibres in the fibre composition to be provided in accordance with Article 9 of this Regulation does not need to be indicated if	dodatka na suvu masu svakog vlakna, u skladu sa Prilogom IX, pri čemu se ne uzimaju u obzir delovi tekstilnih proizvoda iz Priloga VII ovog Pravilnika. 4. Laboratorije odgovorne za ispitivanje tekstilnih mešavina za koje ne postoji jedinstvena metoda analize u Evropskoj Uniji, određuju sirovinski sastav takvih mešavina, navodeći dobijene rezultate, korišćene metode i stepen tačnosti u izveštaju o ispitivanju. Član 20 Odstupanja 1. Prilikom određivanja sirovinskog sastava tekstilnih proizvoda mogu se primeniti odstupanja iz st. 2, 3 i 4 ovog člana. 2. Izuzetno od člana 8 stav 3 ovog Pravilnika, prisustvo stranih vlakana u sastavu vlakana koje se nude u skladu sa članom 9 ovog Pravilnika ne navodi se ako procenat tih vlakana ne prelazi sledeće vrednosti:
---	--	---



këtyre fibrave nuk arrin vlerat e mëposhtme: 2.1. 2% të peshës totale të produktit të tekstilit, me kusht që kjo të arsyetohet si teknikisht e pashmangshme, sipas praktikave të mira të prodhimit dhe të mos shtohet për çështje rutine; ose 2.2. 5% të peshës totale në rastin e produkteve tekstile të cilat i janë nënshtruar procesit të lnuarjes, me kusht që kjo sasi të jetë e arsyetuar si teknikisht e pashmangshme, sipas praktikave të mira të prodhimit dhe të mos shtohet për çështje rutine. 3. Një tolerancë prodhimi prej 3% lejohet ndërmjet përbërjes së deklaruar të fibrave, që përcaktohet në përputhje me nenin 9 të kësaj Rregullore dhe përqindjeve të fituara nga analizat e kryera në përputhje me nenin 19 të kësaj Rregullore, në lidhje me peshën e totale të fibrave që tregohen në etiketë ose shenjë. Kjo tolerancë gjithashtu zbatohet për:	the percentage of those fibres does not reach the following values: 2.1. 2 % of the total weight of the textile product, provided this quantity is justified as being technically unavoidable in good manufacturing practice and is not added as a matter of routine; or 2.2. 5 % of the total weight in the case of textile products which have undergone a carding process, provided this quantity is justified as being technically unavoidable in good manufacturing practice and is not added as a matter of routine. 3. A manufacturing tolerance of 3 % shall be permitted between the stated fibre composition to be provided in accordance with Article 9 of this Regulation and the percentages obtained from analysis carried out in accordance with Article 19 of this Regulation, in relation to the total weight of fibres shown on the label or marking. Such tolerance shall also apply to the following:	2.1. 2% ukupne mase tekstilnog proizvoda, pod uslovom da je ta količina tehnološki opravdana dobrom proizvođačkom praksom, i ne dodaje se rutinski;ili 2.2. 5% ukupne mase u slučaju tekstilnog proizvoda koji je dobijen procesom vlačenja ili kardiranja, ako je ta količina tehnološki opravdana dobrom proizvođačkom praksom, i ne dodaje se rutinski. 3. Za tekstilni proizvod za koji se sirovinski sastav označava odnosno obeležava u skladu sa članom 9 ovog Pravilnika, prihvatljivo je odstupanje od 3% kada se upoređi procenat učešća vlakna navedenog na oznaci ili etiketi i procenat učešća tog vlakna dobijen ispitivanjem u skladu sa članom 19 ovog Pravilnika: Ovo odstupanje primenjuje se i
---	---	--



3.1. fibrat të cilat mund të caktohen me termin “fibra të tjera” në përputhje me nenin 9 të kësaj Rregullore; 3.2. përqindjen e leshit të përcaktuar në nenin 8 nën paragrafi 2.2 të kësaj Rregullore. Për qëllime të analizave, tolerancat llogariten veçmas. Pesha e totale që merret parasysh gjatë llogaritjes së tolerancës të përcaktuar në këtë paragraf, është ajo e fibrave të produktit të përfunduar, duke zbritur peshën e çdo fibre të huaj të gjetur gjatë zbatimit të tolerancës së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni. 4. Aplikimi kumulativ i tolerancave të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni lejohet vetëm në rast se ndonjë prej fibrave të huaja të gjetura nga analiza, gjatë zbatimit të tolerancës së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, provojnë të jenë nga i njëjti lloj kimik, si një apo më shumë prej fibrave që tregohen në etiketë ose shenjë.	3.1. fibres which may be designated by the term ‘other fibres’ in accordance with Article 9 of this Regulation; 3.2. the percentage of wool referred to in Article 8 sub paragraph 2.2 of this Regulation. For the purposes of the analysis, the tolerances shall be calculated separately. The total weight to be taken into account in calculating the tolerance referred to in this paragraph shall be that of the fibres of the finished product less the weight of any extraneous fibres found when applying the tolerance referred to in paragraph 2 of this Article. 4. The cumulative application of the tolerances referred to in paragraphs 2 and 3 of this Article shall be permitted only if any extraneous fibres found by analysis, when applying the tolerance referred to in paragraph 2 of this Article, prove to be of the same chemical type as one or more of the fibres shown on the label or marking.	na: 3.1. vlakna koja se mogu nazvati izrazom "ostala vlakna", u skladu sa članom 9 ovog Pravilnika; 3.2. procenat runske vune iz člana 8 stava 2.2 ovog Pravilnika. Za potrebe analize, odstupanja izračunavaju se odvojeno. Ukupna masa koja se uzima u obzir prilikom izračunavanja dozvoljenog odstupanja iz ovog stava je ukupna masa tekstilnih vlakana gotovog proizvoda umanjena za masu "stranih vlakana" nađenih primenom odstupanja iz stava 2 ovog člana. 4. Sabiranje dozvoljenih odstupanja iz st. 2 i 3 ovog člana dozvoljeno je samo ako se ispitivanjem dokaže da su bilo koja pronađena tekstilna vlakna, uz primenu dozvoljenog odstupanja iz stava 2 ovog člana, istog hemijskog sastava, kao i jedna ili više vrsta vlakana prikazanih na etiketi ili oznaci.
---	---	--



5. Në rastin e produkteve të veçanta tekstile, për të cilat procesi i prodhimit kërkon toleranca më të larta nga ato që janë përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, ministri i ministrisë përgjegjëse për çështjet e tregtisë dhe industrisë mund të autorizojë toleranca më të larta. Para vendosjes së produktit të tekstit në treg, prodhuesi paraqet kërkesë për autorizim pranë ministrit të ministrisë përgjegjëse për çështjet e tregtisë dhe industrisë, duke ofruar argumente të mjaftueshme dhe prova për rrethanat e veçanta të prodhimit. Autorizimi mund të jepet vetëm në raste të veçanta dhe kur prodhuesi ofron argumente adekuate për një gjë të tillë. KAPITULLI 4 DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE Neni 21 Dispozita kalimtare Produktet e tekstit të cilat janë në përputhje me Rregulloren nr. 11/2012 për Përmbajtjen e	5. In the case of particular textile products for which the manufacturing process requires tolerances higher than those laid down in paragraphs 2 and 3 of this Article, the Commission may authorise higher tolerances. Prior to placing the textile product on the market, the manufacturer shall submit a request for authorisation by the Commission providing sufficient reasons for and evidence of the exceptional manufacturing circumstances. The authorisation may only be granted in exceptional cases and where adequate justification is provided by the manufacturer. CHAPTER 4 TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS Article 21 Transitional provision Textile products which comply with the Regulation no. 11/ 2012 on contents of raw	5. U slučaju posebnih tekstilnih proizvoda, za koje proizvodni proces zahteva veća odstupanja od onih navedenih u stavovima 2 i 3 ovog člana, ministar ministarstva nadležnog za poslove trgovine i industrije može odobriti veće tolerancije. Pre stavljanja tekstilnog proizvoda na tržište, proizvođač podnosi zahtev za odobrenje ministru ministarstva nadležnom za poslove trgovine i industrije, koji sadrži razloge i dokaze o izuzetnim okolnostima procesa proizvodnje. Ovlašćenje se može odobriti samo u posebnim slučajevima i kada proizvođač obezbedi adekvatne argumente za takvo stvar. POGLAVLJE 4 PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE Član 21 Prelazna odredba Tekstilni proizvodi koji su u skladu sa Uredbom br. 11/2012 o Sirovinskom Sastavu
--	--	--



Lëndës së Parë dhe Emërtimet e Tekstilit, dhe të cilat lëshohen në treg para fillimit të zbatimit të kësaj Rregulloreje mund të vazhdojnë të jenë në dispozicion në treg deri më datën 30 Qershor 2018. Neni 22 Shfuqizimi 1.Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen rregulloret e mëposhtme: 1.1. Rregullore Nr. 01/2012 për Metodën e Analizës Sasiore të Përzierjeve Tre Komponente të Fibrave të Tekstilit; 1.2. Rregullore Nr.11/2012 për Përmbajtjen e Lëndës së Parë dhe Emërtimet e Tekstilit; 1.3.Rregullore Nr.12/2012 mbi Metodën e Analizave Kuantitative të Përzierjeve Dykomponentësh të Fibrave të Tekstilit.	material and textile labelling and which are placed on the market before the start of application of this Regulation may continue to be made available on the market until 30 June 2018. Article 22 Repeal 1.With effect from entering into force of this Regulation the following regulations are repealed: 1.1.Regulation no. 1/2012 on methods for the quantitative analysis of ternary textile fibre mixtures; 1.2.Regulation no. 11/ 2012 on contents of raw material and textile labelling; 1.3.Regulation no. 12/ 2012 on methods for the quantitative analysis of binary textile fibre mixtures.	i Nazivima Tekstila, i koji se stavljaju na tržište pre primenjivanja ove Uredbe mogu biti dostupni na tržište do 30 Juna 2018. Član 22 Ukidanje Nakon stupanja na snagu ovog Pravilnika, sledeći propisi se ukidaju: 1.1.Uredba Br. 01/2012 o Metodama Kvantitativne Analize Tri Komponentnih Mešovina Tekstilnih Vlakana; 1.2.Uredba Br. 11/2012 o Sirovinskom Sastavu i Nazivima Tekstila; 1.3.Uredba Br. 12/2012 o Metodama Kvantitativne Analize Dvokomponentnih Mešovina Tekstilnih Vlakana.
---	--	--



Neni 23 Hyrja në fuqi Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Bajram Hasani Minister i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Prishtinë, 05.03.2018	Article 23 Entry into force This Regulation enters into force 7 (seven) days after it is signed by the Minister of the Ministry of Trade and Industry. Bajram Hasani Minister of the Ministry of Trade and Industry Prishtinë, 05.03.2018	Član 23 Stupanje na snagu Ovaj Pravilnik stupa na snagu 7 (sedam) dana od dana potpisivanja od strane Ministra Ministarstva Trgovine i Industrije. Bajram Hasani Ministar u Ministarstvo Trgovine i Industrije Priština, 05.03.2018
---	---	---



SHTOJCA I
LISTA E EMRAVE TË FIBRAVE TEKSTILE

(Referuar në nenin 5)

Tabela 1

Numri	Emri	Përshkrimi i fibrave
1	Lesh	Fibra nga leshi i deles ose qengjit (<i>Ovis aries</i>) ose përzierje e fibrave të leshit të deles ose qengjit dhe qimeve të kafshëve të në numrin 2
2	Alpakë, lama, deve, kashmir, angora, vikuna, jak, guanako, kashgora, vidër, kastor, përcillet me ose pa fjalën 'lesh' ose 'qime'	Qimet e llojeve tjera shtazore: alpaka, lama, deve, dhia kashmir, dhia angore, lepur angore, vikuna, jak, guanako, dhi kashgor, kastor, vidër.
3	Qimet e kafshëve ose kuajve, me ose pa paraqitjen e llojeve të kafshëve (p.sh qimet e gjedheve, qimet e dhive të zakonshme, qimet e llojeve të kuajve)	Qimet e llojeve të ndryshme të kafshëve të cilat nuk janë të evidentuara në numrat 1 dhe 2
4	Mëndafsh	Fibrat të cilat përfitohen ekskluzivisht nga insektet të cilat sekretojnë mëndafsh.
5	Pambuk	Fibrat e fituara nga farat e bimëve të pambukut (<i>Gossypium</i>)
6	Kapok	Fibrat e fituara nga brendia e frutës kapok (<i>Ceiba pentandra</i>)



7	Fije liri (ose linë)	Fibrat e fituara nga kërcelli i bimës së lirit (<i>Linum usitatissimum</i>)
8	Kërpi i vërtetë	Fibrat e fituara nga kërcelli i bimës së kërpit (<i>Cannabis sativa</i>)
9	Juta	Fibrat e fituara nga kërcelli i bimës së <i>Corchorus olitorius</i> dhe <i>Corchorus capsularis</i> . Për qëllimet e kësaj Rregullore, fibrat e fituara nga këto bimë duhet të trajtohen si juta: <i>Hibiscus cannabinus</i> , <i>Hibiscus sabdariffa</i> , <i>Abutilon avicennae</i> , <i>Urena lobata</i> , <i>Urena sinuata</i>
10	Abakë (Kërp Manile)	Fibrat e fituara nga këllëfi i gjethit të <i>Musa textilis</i>
11	Alfa ose esparto	Fibrat e fituara nga gjethet e <i>Stipa tenacissima</i>
12	Coir (arra e kokosit)	Fibrat e fituara nga fruta e <i>Cocos nucifera</i>
13	Gjineshtra	Fibrat e fituara nga kërcelli i <i>Cytisus scoparius</i> dhe/ose <i>Spartium Junceum</i>
14	Ramia	Fibrat e fituara nga kërcelli i <i>Boehmeria nivea</i> dhe <i>Boehmeria tenacissima</i>
15	Sisali	Fibrat e fituara nga gjethet e <i>Agave sisalana</i>
16	Sunn	Fibrat e fituara nga kërcelli i <i>Crotalaria juncea</i>
17	Henequen	Fibrat e fituara nga kërcelli i <i>Agave fourcroydes</i>
18	Maguey	Fibrat e fituara nga kërcelli i <i>Agave cantala</i>

Tabela 2

Numri	Emri	Përshkrimi i fibrave
-------	------	----------------------



19	Acetat	Fibrat e acetatit të celulozës në të cilat më pak se 92 % por së paku 74 % të grupeve hidrokside janë acetiluar
20	Alginat	Fibrat e fituara nga kripërat metalike të acidit alginik
21	Kupro	Fibrat e regjeneruara të celulozës, të fituara nga procesi kupro-amoniakor
22	Modale	Fibrat e regjeneruara të celulozës, të fituara nga procesi i modifikuar i viskozës, duke ushtruar forcë të lartë këputëse dhe modulet me lagështi të lartë. Forca këputëse (B_C) në gjendje të kondicionuar dhe forca (B_M) e nevojshme për të prodhuar një zgjatje prej 5% në gjendje të lagësht, janë: $B_C \text{ (cN)} \geq 1,3 \sqrt{T + 2T}$ $B_M \text{ (cN)} \geq 0,5 \sqrt{T}$ ku, T është densiteti mesatar i gjatësisë në deciteks (dtex)
23	Proteina	Fibrat e fituara nga substancat e proteinave natyrore të regjeneruara dhe stabilizuara me veprimin e reagjentëve kimikë
24	Tri-acetatët	Fibrat e acetatit të celulozës, ku së paku 92 % e grupeve hidrokside janë acetiluar
25	Viskozë	Fibrat e regjeneruara të celulozës, të fituara përmes procesit të viskozës për fibrat e holla dhe të pa ndërprera
26	Akrilik	Fibrat e formuara nga makro-molekulat lineare të cilat përbëjnë së paku 85% (në masë) të vargut të tyre akrilonitrilik
27	Fibrat klorure	Fibrat e formuara nga makro-molekulat lineare që në vargun e tyre kanë më shumë se 50% (në



		masë) njësi monomerësh të vinilit të kloruar ose vinilidenit të kloruar
28	Fibrat florure	Fibra të formuara nga makro-molekulat lineare të prodhuara nga monomeret alifatike të fluorurokarbonit
29	Modakrilik	Fibra të formuara nga makro-molekulat që në vargun e tyre kanë më shumë se 50% dhe më pak se 85% (në masë) të vargut akrilonitrilik
30	Poliamidet ose najloni	Fibrat e formuara nga makro-molekulat lineare të cilat në vargun e tyre përmbajnë grupe amide të përsëritshme, prej të cilave së paku 85 % e tyre janë të lidhura me njësitë alifatike ose cikloalifatike
31	Aramidet	Fibra të formuara nga makro-molekulat sintetike lineare të ndërtuara nga grupe aromatike të bashkuara me lidhje amide ose imide, nga të cilat të paktën 85% e tyre janë të lidhura direkt me dy unaza aromatike dhe me një numër lidhjesh imide, të cilat, nëse janë prezent, nuk e tejkalojnë numrin e lidhjeve amide.
32	Poliamidet	Fibra të formuara nga makro-molekulat sintetike lineare që në vargun e tyre kanë njësi imide periodike
33	Liocet	Fibër e regjeneruar e celulozës e përfutur me tretje, dhe një proces tjerreje me tretës organik (përzjerje e reagjentëve organik dhe ujë), pa formim të derivateve
34	Polilaktide	Fibra të formuara nga makro-molekulat lineare që në varg kanë të paktën 85% (për nga masa) njësi esterike të acidit laktik, që rrjedh nga sheqernat që hasen në natyrë, dhe të cilat kanë një temperaturë shkrirjeje të paktën 135°C
35	Poliesteri	Fibra të formuara nga makro-molekulat lineare që në vargun e tyre përmbajnë së paku 85% (në masë) të një esteri të acidit diol dhe teraftalik



36	Polietileni	Fibrat e formuara nga makro-molekulat lineare të hidrokarbureve të ngopura alifatike
37	Polipropileni	Fibra të formuara nga një makro-molekulë lineare e hidrokarbureve të ngopura alifatike ku një atomi i dytë i vargut karbonik bart një varg anësor metili me natyrë izostatike dhe pa zëvendësime të mëtejshme
38	Polikarbamidi	Fibrat e formuara nga makro-molekulat lineare të cilat në vargun e tyre përmbajnë grupe funksionale të përsëritura të ureilenit (NH-CO-NH)
39	Poliuretani	Fibrat e formuara nga makro-molekulat lineare të cilat në vargun tyre përmbajnë grupin funksional të përsëritur të uretanit
40	Vinilal (alkooli vinilit)	Fibra të formuara nga makro-molekulat lineare vargu karbonik i të cilave përbëhet nga polivinil alkooli me nivele të ndryshme acetilimi
41	Trevinili	Fibra të formuara nga polimeri terciar akrilonitrilik, një monomer i vinilit të kloruar dhe nga një monomer i tretë i vinilit, ku asnjëri prej tyre nuk përfaqëson më shumë se 50% të masës së përgjithshme
42	Elastodienet	Fibra elastike të përbëra nga poli-isopreni natyral ose sintetik, ose të përbëra nga një ose më shumë diene të polimerizuara me ose pa një ose më shumë monomere të vinilit, dhe të cilat, kur zgjaten deri në tre herë të gjatësisë së tyre fillestare, rikthehen në mënyrë të shpejtë dhe të qenësishme në gjatësinë e tyre fillestare.
43	Elastine	Fibrat elastike të përbëra nga së paku 85% (në masë) e poliuretanit të segmentuar, të cilat kur zgjaten deri në tre herë të gjatësisë së tyre fillestare, rikthehen në mënyrë të shpejtë dhe të qenësishme në gjatësinë e tyre fillestare.



44	Fibër qelqi	Fibra të formuara nga qelqi
45	Elastomultiesteri	Fibra të formuara nga ndërveprimi i dy ose më shumë makro-molekulave lineare kimikisht të dallueshme, në dy ose më shumë faza (prej të cilave asnjëra nuk kalon 85% të masës) e cila përmban grupet esterike si njësi funksionale dominuese (të paktën 85%) dhe të cilat, pas trajtimit të detyrueshëm kur zgjaten në gjatësi një herë e gjysmë më shumë se gjatësia e fillestare rikthehen shpejt dhe qenësisht në gjatësinë e tyre fillestare.
46	Elastolefina	Fibër e formuar nga të paktën 95 % (në masë) e makro-molekulës pjesërisht të ndërlidhur, e bërë nga etileni dhe nga të paktën një olefinë, dhe e cila kur zgjatet një herë e gjysmë më shumë se gjatësia fillestare saj rikthehet shpejt dhe qenësishëm në gjatësinë e tij fillestare.
47	Melamina	Fibër e formuar prej të paktën 85% të masës së makro-molekulave me lidhje të tërthorta të bëra nga derivatet e melaminës
48	Emri i cili korrespondon me materialin nga i cili përbëhen fibrat p.sh. metali (metalike, të metalizuara), azbesti, letra, e të pasuara ose jo me fjalën ‘fije’ ose ‘fibër’	Fibra të përfutuara nga materiale të ndryshme apo materiale të reja që nuk janë të listuara më lartë.



SHTOJCA II

KËRKESAT MINIMALE NË LIDHJE ME SPECIFIKACIONIN TEKNIK QË DUHET TË PËRFSHIHET NË APLIKACIONIN PËR EMËRIN E NJË FIBRE TË RE TEKSTILE

(Referuar në nenin 6)

Specifikacioni teknik që duhet të bashkëngjitet në aplikacionin për përfshirjen e emërit të një fibre të re tekstile në listën e përcaktuar në Shtojcën I, siç parashihet në nenin 6, duhet të përmbajë të paktën këto informata:

(1) Emrin e propozuar të fibrës së tekstilit:

Emri i propozuar duhet të ketë lidhje me përbërjen kimike dhe, nëse është e përshtatshme, duhet të ofroj informacione rreth karakteristikave të fibrave. Emri i propozuar duhet të jetë i lirë nga çdo e drejtë e pronësisë intelektuale dhe nuk duhet të lidhet me prodhuesin.

(2) Përkufizimin e propozuar të fibrës së tekstilit:

Karakteristikat e përmendura në përkufizimin e fibrave të reja të tekstilit, siç është elasticiteti, duhet të verifikohen përmes metodave të testimit të cilat duhet të sigurohen me specifikacionin teknik së bashku me rezultatet e analizave eksperimentale.

(3) Identifikimi i fibrës tekstile: formula kimike, dallimet nga fibrat ekzistuese të tekstilit, së bashku me të dhënat e detajuara, kur janë të rëndësishme, siç janë pika e shkrirjes, dendësia, indeksi i thyerjes, reagimi ndaj djegies dhe spektri FTIR.

(4) Kufijtë e lejuar të propozuar dhe miratuar që duhet të përdoren në llogaritjen e përbërjes së fibrës.

(5) Metodatat e zhvilluara mjaftueshëm të kuantifikimit dhe identifikimit, duke përfshirë të dhënat eksperimentale:

Aplikuesi duhet të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të metodave të listuara në Shtojcën VIII ose standardet e harmonizuara që duhet përfshihen në Shtojcë, për të analizuar përzierjet më të pritura komerciale të fibrave tekstile me fibrat e tjera, si dhe të propozojë së paku një nga këto metoda. Për këto metoda ose standarde të harmonizuara ku fibra tekstile mund të konsiderohet si



komponent i patretshëm, aplikuesi duhet të shqyrtojë faktorët korrigjues të masës së fibrave të reja tekstile. Të gjitha të dhënat eksperimentale duhet të dorëzohen bashkë me aplikacionin.

Nëse metodat e listuara në këtë Rregullore nuk janë të përshtatshme, atëherë aplikuesi duhet të jap arsye adekuate dhe të propozoj një metodë të re.

Aplikimi duhet të përmbaj të gjitha të dhënat eksperimentale për metodat e propozuara. Në specifikacion duhet të jepen të dhënat lidhur me saktësinë, qëndrueshmërinë dhe përsëritshmërinë e metodave.

- (6) Informatat shkencore në dispozicion lidhur me reaksionet e mundshme alergjike apo efektet tjera negative të fibrave të reja të tekstilit në shëndetin e njeriut, përfshirë rezultatet e testeve të kryera për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin përkatës.
- (7) Informata shtesë në mbështetje të aplikacionit: procesi i prodhimit, rëndësia e konsumatorit.

Prodhuesi ose cilido person që vepron në emër të prodhuesit duhet të ofrojë mostra përfaqësuese të fibrës së re e të pastër tekstile, dhe përzierjet e nevojshme të fibrës tekstile përkatëse për të provuar vlefshmërinë e metodave të propozuara të identifikimit dhe kuantifikimit. Komisioni i BE-së mund të kërkojë, nga prodhuesi ose personi që vepron në emër të prodhuesit, mostra të tjera të përzierjes përkatëse të fibrës.



SHTOJCA III

EMËRTIMET E REFERUARA NË NENIN 8, PARAGRAFI 1

- në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës:
- në anglisht: ‘lesh i qethur’ ose ‘lesh pastër’



SHTOJCA IV

DISPOZITAT E VEÇANTA PËR ETIKETIMIN DHE SHËNJIMIN E PRODUKTEVE TË CAKTUARA TË TEKSTILIT

(Referuar në nenin 13)

Produktet	Dispozitat për etiketim dhe shënjim
1. Produktet e mëposhtme të korseterisë:	Përbërja e fibrave duhet të paraqitet në etiketë dhe shënjim, duke deklaruar përbërjen e tërë produktit, ose si pjesë përbërëse apo veçmas, ato të komponentëve të listuara në mënyrë përkatëse:
(a) Gjoksore	Pjesa e jashtme dhe e brendshme e sipërfaqeve të formave (kupave) dhe shpinës (kurrizit)
(b) Korsetë dhe breza	Pjesët e parme, pasme dhe anash
(c) Korse	Materiali i pjesëve të brendshme dhe të jashtme të sipërfaqes së formave (kupave), pjesët ngurtësuar të përparme dhe të pasme, si dhe pjesët anësore.
2. Produktet tjera të korseterisë, që nuk janë listuar më sipër	Përbërja e fibrave duhet të paraqitet përmes deklarimit të përbërjes së tërë produktit ose, çoftë veçmas apo bashkërisht, komponentëve të ndryshme të produktit. Ky emërtim nuk është i detyrueshëm për komponentët që përfaqësojnë më pak se 10% të peshës së përgjithshme të produktit.
3. Të gjitha produktet e korseterisë	Etiketimi dhe shënjimi i ndarë i pjesëve të ndryshme të produkteve të korseterisë bëhet në mënyrë të tillë që konsumatori të kuptojë me lehtësi se cilës pjesë të produktit i referohet informacioni në etiketë dhe shenjë.



4. Tekstile të gravuara me shtypje	Përbërja e fibrave jepet për produktin si tërësi dhe mund të jepet përmes deklarimit veçmas të përbërjes së stofit bazë dhe atë të pjesëve të gravura. Këta komponentë duhet të përmenden me emër.
5. Tekstile të qëndisura	Përbërja e fibrave jepet për produktin si tërësi dhe mund të paraqitet duke deklaruar veçmas përbërjen e stofit bazë dhe atë të perit të qëndisjes. Këta komponentë duhet të përmenden me emër. Ky lloj emërtimi apo etiketimi është i detyrueshëm vetëm për pjesët e qëndisura të cilat arrijnë të paktën 10% të sipërfaqes së produktit.
6. Fijet të cilat përbehen nga baza dhe mbështjellësi i fijos, i punuar nga fibrat e ndryshme dhe të cilat vihen në dispozicion në treg si të tilla për konsumatorët	Përbërja e fibrave jepet për produktin si tërësi dhe mund të paraqitet duke deklaruar veçmas përbërjen e bazës dhe mbështjellësin e fijosve. Këta komponentë duhet të përmenden me emër.
7. Tekstile kadife dhe pelush ose tekstile të ngjashme me kadifen ose pelushin	Përbërja e fibrave paraqitet për tërë produktin dhe, kur produkti përmban pjesën e prapme dhe një shtresë të përdorshme të përberë nga fibra të ndryshme, mund të deklarohet ndaras për ato komponentë. Këta komponentë duhet të përmenden me emër.
8. Mbulesa dyshemesh dhe qilimash, pjesa e prapme dhe shtresa e përdorshme përbehet prej fibrave të ndryshme.	Përbërja e fibrave mund të deklarohet vetëm për shtresën e përdorshme. Shtresa e përdorshme duhet të përmendet me emër.



SHTOJCA V

PRODUKTET E TEKSTILIT PËR TË CILAT ETIKETIMI OSE SHËNJIMI NUK ËSHTË I DETYRUESHËM (Referuar në nenin 17 paragrafi 2)

1. Shirit/Këllëfi mbështetës i mëngës;
2. Rripa orësh prej materialeve tekstile;
3. Etiketa dhe distinktivë (shenja dalluese);
4. Dorëz për kapjen e enëve të mbushura të kuzhinës, të punuara nga materialet e tekstit;
5. Mbështjellëse dekorative prej tekstili për filxhanë/tasa të kafesë;
6. Mbështjellëse dekorative prej tekstili për filxhanë/tasa të çajit;
7. Mëngë mbrojtëse për duar;
8. Dorashka të punuara nga gëzofi, përveç atyre të punuara nga grumbull thekë tekstili;
9. Lule artificiale;
10. Jastëkë për të mbajtur gjilpërat;
11. Kanavacë e pikturuar;
12. Produkte tekstile për materiale bazë apo të shtrojës dhe për përforcim;
13. Produkte të punuara nga materiale të vjetra të tekstit, të cilat deklarohen në mënyrë eksplicite se janë të tilla;
14. Mbrojtëse këmbesh;
15. Paketime, jo të reja dhe të shitura si të tilla;



16. Produkte zbukurimi dhe shala për kuaj të punuara prej materialeve të tekstilit;
17. Pajisje udhëtimi prej materialeve të tekstilit;
18. Tapiceri të qëndisura me dorë, të përfunduara ose jo, si dhe materialet për prodhimin e tyre, duke përfshirë penjte e qëndisjes, të shitur ndaras nga kanavacat dhe të paraqitura enkas për përdorim në tapiceri të tilla;
19. Shtrënguese për veshje/zinxhirë;
20. Butona dhe kopsa të mbuluara me material tekstili
21. Mbulesa librash prej materialeve të tekstilit;
22. Lodra;
23. Pjesët e mbathjeve prej tekstili;
24. Mbulesa tavolinash të cilat kanë disa komponentë dhe sipërfaqe jo më të madhe se 500 cm²;
25. Dorëza/veshje për enë të nxehta;
26. Mbulesa dekorative për vezë;
27. Çanta të kozmetikës;
28. Qese të duhanit, të punuara nga materiali i tekstilit;
29. Kuti për mbajtjen e syzeve, cigareve dhe purove, çakmakëve dhe krehrave të punuara nga materiali i tekstilit;
30. Mbështjellëse për telefona celularë dhe për pajisje tjera elektronike të lëvizshme me një madhësi jo më të madhe se 160cm²;
31. Rekuizita mbrojtëse për sporte, me përjashtim të dorëzave;
32. Kuti tualeti;
33. Kuti për pastrim këpucësh;
34. Produkte funerali;
35. Produkte për një përdorim, me përjashtim të vatës;
36. Produkte tekstili të cilat i nënshtrohen rregullave të Farmakopës Evropiane dhe të mbuluara me referimin e atyre rregullave, fasha njëpërdorimshme për përdorime mjekësore dhe ortopedike, si dhe në përgjithësi produkte ortopedike të tekstilit.



37. Produkte tekstili, duke përfshirë: litarë, konop, dhe tela, qe i nënshtrohen pikës 12 të Shtojcës VI, zakonisht të destinuara për:
- (a) përdorim si komponentë për pajisje të prodhimit dhe përpunimit të mallrave;
 - (b) përfshirje në makineri, instalime (p.sh për ngrohje, kondicioner të ajrit apo për ndriçim), në pajisje shtëpiake dhe të tjera, në makina dhe mjete tjera të transportit, ose për operimin e tyre, për mirëmbajtje ose pajisje, përveç mbulesave të gomuara dhe aksesoreve prej tekstili të mjeteve të motorizuara te cilat shiten veçmas nga makina.
38. Produkte tekstili për qëllime mbrojtjeje dhe sigurie si p.sh rripat e sigurisë, parashutat, jelekët e shpëtimit, parashutat emergjente, pajisjet për zjarrfikje, jelek antiplumb dhe veshje tjera të posaçme mbrojtëse (si p.sh për mbrojtje kundër zjarrit, substancave kimike ose rreziqeve tjera të sigurisë);
39. Struktura të mbështetura në ajër (si p.sh. salla sportive, stenda ekspozitash ose objekte magazinimi), me kusht që për to të jenë dhënë detaje të performancës dhe specifikacionet teknike;
40. Velat;
41. Veshjet për kafshët;
42. Flamuj dhe banerë;



SHTOJCA VI

PRODUKTE TË TEKSTILIT PËR TË CILAT ETIKETIMI INKLUZIV ËSHTË I MJAFTUESHËM

(Referuar në nenin 17(3))

1. Lecka për dysHEME
2. Lecka për pastrim
3. Skajore dhe shirita/stoli
4. Tentene (punime dore me grep)
5. Rripa
6. Shtrëngesa
7. Aski pantallonash dhe mbajtëse çorapësh
8. Lidhëse të këpucëve dhe çizmeve
9. Fjongo
10. Llastik
11. Paketime të reja, të shitura si të tilla
12. Shirit paketime dhe spango bujqësore; shirita, spango dhe litarë tjerë, përveç atyre që klasifikohen në pikën 37 të Shtojcës V¹
13. Shtroja tavolinash
14. Shami/faculeta
15. Shtrëngesat dhe rrjetat e flokëve
16. Kravata dhe kordele për fëmijë

¹ Veshjet për kafshët; Për produktet që i përkasin këtij artikulli dhe që shiten në gjatësi të prera, etiketimi inkluziv do të jetë ai i mbështjelljes. Spangot dhe litarët që i përkasin këtij artikulli, i përfshinë ato të përdorura në alpinizëm dhe sporte të ujit.



17. Përparëset, dorëzat për pastrim dhe peshqirët për fytyrë
18. Lloje të ndryshme të fijeve për qepje, riparime, qëndisje për shitje me pakicë në sasi të vogla me një peshë neto prej 1 gram ose më pak.
19. Shirit për perde, roleta dhe kapakë.



SHTOJCA VII

ARTIKUJT QË NUK DUHET TË MERREN PARASYSH PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË FIBRAVE

(Referuar në nenin 19, paragrafi 2)

Produktet	Pikat e përjashtuara
(a) Të gjitha produktet e tekstit	(i) Pjesët jo-tekstile tegelat, etiketat dhe shenjat, zbukurime dhe stoli që nuk formojnë një pjesë përbërëse të produktit, butonat dhe kopsat e mbuluara me materiale të tekstit, aksesoret, dekoratat, shirita jo-elastikë, fije elastike dhe bendet e shtuara në pika të caktuara dhe të kufizuara të produktit dhe që janë subjekt i kushteve të përcaktuara në nenin 10, fibrave të veçuara, të dukshme, të cilat janë thjesht dekorative, si dhe fibrat me efekt anti statik. (ii) Substanca yndyrore, lidhëset, peshues, matës dhe veshës, produktet e ngopura, produktet shtesë të ngjyrosjes dhe printimit, si dhe produkte të përpunimit të tekstit
(b) Mbulesat e dyshemesë dhe qilimat	Të gjitha komponentët tjerë, përveç sipërfaqes së përdorshme
(c) Materialet për tapiceri	Lidhës dhe mbushës të bazës së indit të cilat nuk formojnë pjesë të sipërfaqes së përdorshme
(d) Varëset dhe perdet	Lidhës dhe mbushës të bazës së indit të cilat nuk formojnë pjesë të anës së mbarë të stofit/materialit
(e) Çorapët	Fije elastike shtesë, të përdorura në manshetë, si dhe fije përforcuese dhe të shtangies për pjesën e gishtave të këmbës dhe thembrës
(f) Gete	Fije elastike shtesë, të përdorura në pjesën e belit, si dhe fije përforcuese dhe të shtangies për pjesën e



	gishtave të këmbës dhe thembrës
(g)Produkte të tekstilit të tjera prej atyre të dhëna në pikat prej (b) deri (f)	Materiali bazik apo i prapmë, përforcime, kanavaca, qepje dhe montime nëse ato zëvendësojnë bazën dhe indin e pëlhurës, mbushjet që nuk kanë ndonjë funksion izolues dhe, sipas nenit 11 (2). Për qëllimet e kësaj dispozite: (i)Materiali bazë i produkteve të tekstilit të cilat shërbejnë si mbështetje në sipërfaqen e përdorur, sidomos në batanije dhe stofra të dyfishta, si dhe pjesë a prapme e kadifes prej pëlhurave dhe të produkteve nuk do të konsiderohen si materiale ana e prapme nuk lëvizë; (ii)‘fije përforcimi’ nënkupton fjetet e materialeve të shtuara në pika të caktuara dhe të kufizuara të produkteve të tekstilit, për t'i forcuar ose për t'i dhënë atyre shtangësi ose trashësi.



SHTOJCA VIII

METODAT PËR ANALIZËN SASIORE TË PËRZIERJEVE TË FIBRAVE TË DYFISHTA DHE TREFISHTA TË TEKSTILIT

(Referuar në nenin 19 paragrafi 1)

KAPITULLI 1

I. Përgatitja e mostrave për teste laboratorike dhe testimi i mostrave përfaqësuese për të përcaktuar përbërjen e fibrave të produkteve të tekstilit

1. FUSHA E APLIKIMIT

Ky kapitull jep procedurat për marrjen e mostrave për teste laboratorike të një madhësie të përshtatshme për trajtimin paraprak për analizën sasiore (d.m.th. pjesë të një masë që nuk kalon 100 g) nga mostrat e përgjithshme laboratorike, dhe për përzgjedhjen e mostrave për testim laboratorik që janë trajtuar paraprakisht për të larguar materiet jo-fibroze ⁽¹⁾.

2. PËRKUFIZIMET

2.1. Burimet nga sasitë e mëdha

Sasia e materialit e cila vlerësohet mbi bazën e një serie të rezultateve të testimit. Kjo mund të përfshijë, për shembull, gjithë materialin e një dërgese të pëlhurës/leckës; tërë pëlhurën e thurur nga një bosht i caktuar i thurjes; një grumbull/hallke e fijeve, një tubë ose më shumë tuba të fibrave të papërpunuara.

2.2. Mostra e përgjithshme laboratorike



Pjesa nga burimi i sasisë së përgjithshme, e marrë për të qenë si mostër përfaqësuese e gjithë materialit që është në dispozicion në laborator. Madhësia dhe natyra e mostrës së përgjithshme laboratorike duhet të jetë e mjaftueshme për të tejkaluar në mënyrë të përshtatshme ndryshueshmërinë e burimit në sasi të madhe dhe për të lehtësuar trajtimin në laborator (2).

2.3. Mostra për testim laboratorik

Pjesa e mostrës laboratorike të përgjithshme që i është nënshtruar trajtimit paraprak për të hequr përbërjet jo-fibroze, nga të cilat janë marrë mostrat për testim. Madhësia dhe natyra e mostrës për testim laboratorik duhet të jetë e mjaftueshme për të tejkaluar në mënyrë të përshtatshme ndryshueshmërinë e mostrës së përgjithshme laboratorike (3).

2.4. Mostrat për testim

Pjesa e materialit të kërkuar për të dhënë një rezultat të testimit, dhe e përzgjedhur nga mostra për test laboratorik.

3. PARIMI

Mostra për testim laboratorik është zgjedhur në mënyrë që ajo të jetë përfaqësuese e mostrës së përgjithshme laboratorike.

Mostrat e testit janë marrë nga mostra laboratorike me shumicë në mënyrë të tillë që secila prej tyre të jetë përfaqësuese e mostrës së testimit laboratorik.

4. MOSTRAT NGA FIBRAT E LIRA

4.1. Fibrat e pa orientuara

Merrni një mostër për testim laboratorik duke zgjedhur xhufkat në mënyrë të rëndomtë nga mostra e përgjithshme laboratorike. Përziejeni tërë mostrën për testim laboratorik me ane të një lënurëse laboratorike (4). Duke iu nënshtruar trajtimit paraprak të një rrjete apo përzierje, përfshirë edhe fibrat e lirshme dhe fibrat të cilat ngjiten në pajisjen e përdorur për përzierje. Pastaj zgjidhni mostrat për testim, në proporcion me masat përkatëse, nga rrjeta apo përzierja, nga fibrat e lirshme dhe nga fibrat e ngjitura në pajisje.

Nëse rrjeta e lënurës mbetet e paprekur pas trajtimit paraprak, zgjidhni mostrat për testim në mënyrën e përshkruar në pikën 4.2. Nëse rrjeta e lënurjes është e penguar nga trajtimi paraprak, zgjidhni çdo mostër për testim duke larguar në mënyrë të rëndomtë së paku 16 tufa të vogla të madhësisë së përshtatshme dhe përafërsisht të barabartë dhe pastaj kombinoni ato.



4.2. Fibra të orientuara (lënurjet, rrjetat, tufat, fitilat)

Nga pjesët e mostrave të përgjithshme laboratorike të zgjedhura në mënyrë të rëndomtë të prera jo më pak se 10 ndër seksione, secila e masës prej rreth 1 g. Mostra për testim laboratorik i nënshtrohet trajtimit paraprak. Ri-kombino ndër seksionet duke i vendosur ato paralel me njëra tjetrën dhe merrni mostrat për testim duke i prerë ato ashtu që të merret një pjesë e secilës prej tyre në 10 gjatësi.

5. MARRJA E MOSTRAVE TË FIJEVE

5.1. Fijet në pako ose në hallka

Merrni mostrat e të gjitha pakove në mostrën e përgjithshme laboratorike

Tërheq gjatësitë e duhura të vazhdueshme e të barabarta prej secilës pako, qoftë duke i dredhur hallkat me numër të njëjtë të kthimeve në një bosht të prishit (5), ose në ndonjë mënyrë tjetër. Bashko anën e gjatësisë në mënyrë paralele me njëra tjetrën qoftë si një hallkë e vetme apo si një shtëllungë.

Mostra për testim laboratorik i nënshtrohet trajtimit paraprak.

Merrni mostrat nga testimit laboratorik i mostrave duke prerë një grumbull të fijeve në gjatësi të barabartë nga hallka apo shtëllunga, duke u përkujdesur që grumbulli të përmban të gjitha llojet e fijeve në mostër.

Nëse cilësia e fijos është t, dhe numri i pakove të zgjedhura nga mostra e përgjithshme laboratorike është n, pastaj për të fituar një mostër testimi prej 10 g, gjatësia e fijeve që tërhiqet nga çdo pako është 106/ Nt cm.

Nëse nt është lartësia, d.m.th më shumë se 2 000, mbështillni hallkën duke shtrënguar dhe preje atë në dy vende për të bërë një shtëllungë të masës së përshtatshme. Skajet e çdo mostre, në formën e një shtëllunge duhet të jenë të lidhura në mënyrë të sigurt para trajtimit paraprak dhe mostrat për testim të marra nga vendet larg grumbujve lidhëse.

5.2. Fija në bazë

Merrni mostrën për testim laboratorik duke prerë një gjatësi nga fundi i bazës, jo më pak se 20 cm të gjatë dhe që përbëhet nga të gjitha fijet e lëmshit, përveç penjve të tegelit, të cilët përjashtohen. Lidhni grumbullin e fijeve së bashku afër njërit fund. Nëse mostra është shumë e madhe për trajtim paraprak si e plotë, ndaje atë në dy ose më shumë pjesë, secila e lidhur së bashku për trajtim paraprak, dhe



ribashkoni pjesët pasi që secila pjesë veç e veç të jetë trajtuar paraprakisht. Merrni mostrën për testim duke prerë një gjatësi të përshtatshme nga mostra e testimit laboratorik, nga fundi i lidhur i grumbullit, që përmban të gjitha fijet në një lëmsh. Për lëmshin N, fijet e cilësisë t, gjatësia e mostrës testuese në masën prej 1 g është $10^5 / Nt \text{ cm}$.

6. MARRJA E MOSTRAVE TË PËLHURËS

6.1. Nga mostra e përgjithshme laboratorike e përbërë nga një prerje e vetme përfaqësuese e pëlhurës

Preni një shirit diagonal nga njëri cep deri te tjetri cep dhe largoni tegelat. Ky shirit është mostër për testim laboratorik. Për të fituar një mostër testimi laboratorik të x g, zona e shiritit do të jetë $x \cdot 10^4 / G \text{ cm}^2$, ku G është masa e pëlhurës në g/m^2 .

Mostra testuese laboratorike i nënshtrohet trajtimit paraprak dhe më pas preni shiritin në mënyrë transversale në katër gjatësi të barabarta dhe mbivendosni ato. Merrni mostrat për testim nga secila pjesë e materialit duke prerë në të gjitha shtresat ashtu që secila mostër të përmbajë një gjatësi të barabartë të secilës shtresë.

Nëse pëlhura ka një dizajn të thurur, bëni gjerësinë e mostrës së testit laboratorik, të matur paralel me drejtimin e lëmshit, jo më pak se një përsëritje e lëmshit të dizajnit. Nëse arrihet kënaqshmëria me këto kushte dhe nëse mostra e testit laboratorik është shumë e madhe që të trajtohet si tërësi, preni atë në pjesë të barabarta, trajtoji ato paraprakisht veç e veç, dhe mbivendos ato pjesë para zgjedhjes së ekzemplarit për testim, duke pasur kujdes që pjesët përkatëse të dizajnit të mos përkojnë.

6.2. Nga mostra e përgjithshme laboratorike e përbërë prej disa prerjeve

Trajto çdo prerje siç përshkruhet në pikën 6.1, dhe jepni secilin rezultat veç e veç.

7. MARRJA E MOSTRAVE TË PRODUKTIT TË PËRBËRË DHE PRODUKTIT TË PËRFUNDUAR

Mostra e përgjithshme laboratorike zakonisht është një produkt i përbërë ose i përfunduar, ose është pjesë përfaqësuese e njërës.

Kur është e përshtatshme, përcaktoni përqindjen e pjesëve të ndryshme të produktit që nuk kanë të njëjtën përmbajtje të fibrave, për të kontrolluar përputhshmërinë me nenin 11.



Zgjidhni një mostër për testim laboratorik që është përfaqësuese e pjesës së përbërë ose të përfunduar të produktit, përbërja e të cilit duhet të paraqitet në etiketë. Nëse produkti ka disa etiketa, zgjidhni mostrat për testim laboratorik të cilat janë përfaqësuese të secilës pjesë që korrespondojnë me etiketën e caktuar.

Nëse produkti, përbërja e të cilit përcaktohet nuk është uniforme, ai mund të jetë i nevojshëm për të zgjedhur mostrat për testim laboratorik nga çdo pjesë e produktit dhe për të përcaktuar përmasat relative të pjesëve të ndryshme në lidhje me produktin në fjalë.

Pastaj llogarit përqindjet, duke marrë parasysh përmasat relative të pjesëve të mostrës.

Mostrat për testim laboratorik i nënshtrohen trajtimit paraprak.

Pastaj zgjidhni mostrat për testim të cilat janë përfaqësuese të mostrave laboratorike të trajtuara paraprakisht.

II. Njohja me metodat e analizës sasiore të përzierjeve të fibrave të tekstilit

Metodat për analizën sasiore të përzierjeve bazohen në dy procese kryesore, ndarja manuale dhe ndarja kimike e fibrave.

Metoda e ndarjes manuale përdoret kurdo që është e mundur, pasi që ajo zakonisht jep rezultate më të sakta se sa metoda kimike. Kjo metodë mund të përdoret për të gjitha materialet e tekstilit, komponentët e fibrave të të cilave nuk formojnë një përzierje të ngushtë, si për shembull në rastin e fijeve të përbëra nga disa elemente ku secila prej tyre është e përbërë nga vetëm një lloj i fibrave, ose pëlhura në të cilën fibra e lëmshit është llojit të ndryshëm nga lëmshi, ose pëlhurat e thurura në gjendje për t'u shpalosur e të punuara prej fijeve të llojeve të ndryshme.

Në përgjithësi, metodat e analizave kimike sasiore bazohen në zgjidhjen selektive të komponentëve individuale. Pas largimit të një komponenti, mbetja e patretshme peshohet, dhe përqindja e komponentit të tretshëm llogaritet nga humbja në masë. Pjesa e parë e Shtojcës jep të dhënat e zakonshme të analizave të kësaj metode të të gjitha përzierjeve të fijeve të trajtuara në Shtojcë, pavarësisht përbërjes së tyre. Prandaj ajo do të përdoret në përputhje me seksionet pasuese individuale të Shtojcës, të cilat përmbajnë procedurat e hollësishme të zbatueshme për përzierjet e fibrave të veçanta. Kohë pas kohe, një analizë bazohet në ndonjë parim tjetër të ndryshëm prej zgjidhjeve selektive; në raste të tilla, jepen detaje të plota në seksionin e duhur.



Përzierjet e fibrave gjatë përpunimit dhe, në një masë më të vogël, tekstilet e përfunduara mund të përmbajnë përbërje jo-fibroze, të tilla si yndyra, dyllë ose materialet lidhëse, apo materie të tretshme në ujë, qoftë që paraqiten natyrshëm ose që shtohen për të lehtësuar përpunimin. Materia jo-fibroze duhet të largohet para analizës. Për këtë arsye është dhënë një metodë për heqjen e vajrave, yndyrave, dyllit dhe përbërjeve të tretshme në ujë.

Përveç kësaj, tekstili mund të përmbajë rrëshira apo materie tjera të shtuara për t'i dhënë veti të veçanta. Materie të tilla, duke përfshirë ngjyresit në raste të veçanta, mund të nder veprojnë me reagjentë për komponentin e tretshëm dhe/ose mund të largohet pjesërisht ose plotësisht nga reagjenti. Ky lloj i materies së shtuar mund të shkaktojë gabime dhe do të largohet para se të analizohet mostra. Nëse është e pamundur që të mënjanohet materia e tillë e shtuar, atëherë metodat sasiore për analiza kimike sasiore të dhëna në këtë Shtojcë nuk do të jenë të aplikueshme më.

Ngjyra në pëlhurat e ngjyrosura konsiderohet të jetë pjesë përbërëse e fibrave dhe nuk largohet.

Analizat kryhen në bazë të masës së thatë, dhe procedura është dhënë për të përcaktuar masën e thatë.

Rezultati fitohet duke aplikuar në masën e thatë të secilës fibër në kufijtë e lejuar, të listuara në Shtojcën IX.

Para procedimit me çfarëdo analize, të gjitha fibrat e pranishme në përzierje duhet të jenë të identifikuara. Në disa metoda, komponenti i patretshëm i përzierjes mund të tretet pjesërisht në reagjentin e përdorur për të tretur komponentin(-ët) e tretshëm.

Kur është e mundur, zgjedhën ata reagjentë që kanë pak ose aspak efekt në fibra të pa tretshme. Në qoftë se gjatë analizës dihet se do të ndodhë humbja në masë, atëherë rezultati duhet të korrigjohet; për këtë qëllim janë dhënë faktorët e korrigjimit. Këta faktorë janë përcaktuar në disa laboratorë duke trajtuar, me reagjentin e duhur siç specifikohet në metodën e analizës, fibrat e pastruara me anë të trajtimit paraprak.

Këta faktorë korrigjues zbatohen vetëm për fibrat e pa degraduara dhe faktorët e ndryshëm korrigjues mund të jenë të nevojshëm nëse fibrat janë degraduar para ose gjatë përpunimit. Procedurat e dhëna zbatohen për përcaktimet të vetme.

Duhet të bëhen të paktën dy përcaktime në mostra të testimit të ndara, si në rastin e ndarjes manuale ashtu edhe në rastin e ndarjes kimike.



Për konfirmim, përveç nëse teknikisht është e pamundur, rekomandohet të përdoren procedurat alternative ku përbërësi që ka qenë mbetje në metodën standarde, tretet i pari.

KAPITULLI 2

METODAT PËR ANALIZËN SASIORE TË PËRZIERJEVE TË CAKTUARA TË FIBRAVE DYFISHE TË TEKSTILIT

I. Informacione të përgjithshme të zakonshme për metodat e dhëna për analizën sasiore kimike të përzierjeve të fibrave tekstilit

I. 1. FUSHA E APLIKIMIT

Fusha e aplikimit për secilën metodë përcakton se për cilat fibra kjo metodë është e aplikueshme.

I. 2. PARIMI

Pas identifikimit të komponentëve të një përzierje, materiali jo-fibroz është larguar nga trajtimi i përshtatshëm paraprak dhe më pas një nga komponentët, zakonisht përmes tretjes selektive⁽⁶⁾. Mbetja e patretshme peshohet dhe përqindja e komponentit të tretshëm llogaritet nga humbja në masë. Përveç kur kjo paraqet vështirësi teknike, preferohet që të tretet fibra e pranishme në proporcion më të madh, duke fituar kështu fibra të pranishme në përqindje më të vogël si mbetje.

I. 3. MATERIALET DHE PAJISJET

I.3.1. Aparatura

I.3.1.1. Enët e filtrimit dhe shishet për peshim të cilat janë mjaftueshëm të mëdha për të përmbajtur enë të tilla për filtrim, apo ndonjë aparaturë tjetër e cila jep rezultate identike.

I.3.1.2. Baloni me vakum.

I.3.1.3. Eksikatori (ena tharëse) e cila përmban gel silici vete tregues.

I.3.1.4. Furrë ventiluese për tharjen e mostrave në 105 ± 3 °C.



I.3.1.5. Peshorja analitike, me saktësi prej 0,0002 g.

I.3.1.6. Ekstraktuesi "Soxhlet" apo ndonjë aparaturë tjetër që jep rezultate identike.

I.3.2. Reagjentët.

I.3.2.1. Naftë e lehtë, e ri-distiluar, me pikë vlimi ndërmjet 40 deri në 60 °C.

I.3.2.2. Reagjentët tjerë janë specifikuar në pjesën përkatëse të secilës metodë.

I.3.2.3. Ujë i distiluar ose dejonizuar.

I.3.2.4. Aceton.

I.3.2.5. Acid ortofosforik.

I.3.2.6. Ure.

I.3.2.7. Bikarbonat natriumi.

Të gjithë reagjentët e përdorur duhet të jenë kimikisht të pastër.

I.4. PËRSHTATJA DHE RREGULLIMI I ATMOSFERËS PËR TESTIM

Për shkak se përcaktohen masat e thara, nuk është e nevojshme që të rregullohet temperatura e mostrës përfaqësuese apo që të kryen analizat në atmosferë të rregulluar.

I.5. MOSTRA LABORATORIKE

Merrni një mostër për testim laboratorik që është përfaqësuese e mostrës së përgjithshme laboratorike dhe që është e mjaftueshme për të siguruar të gjitha mostrat që janë të nevojshme, secila prej së paku 1 g.

I.6. TRAJTIMI PARAPRAK I MOSTRËS LABORATORIKE (7)

Kur është e pranishme një substancë e cila nuk duhet të merret parasysh në llogaritjen e përqindjes (shih Nenin 19), ajo substancë duhet të largohet e para me një metodë të përshtatshme që nuk ndikon në cilindo prej përbërësve të fibrave.



Për këtë qëllim, materia jo-fibroze e cila mund të ekstrahohet me anë të naftës së lehtë dhe uji largohet duke e trajtuar mostrën për testim laboratorik në një aparaturë për ekstraktim "Soxhlet" me naftë të lehtë, për 1 orë, me shkallë minimale të cikleve prej gjashtë cikleve për orë. Lejo naftën e lehtë që të avullohet nga mostra, e cila pastaj ekstrahohet përmes trajtimit direkt, përfshinë zhytjen e mostrës laboratorike në ujë në temperaturë të dhomës për 1 orë, dhe më pas duke e zhytur në ujë në temperaturë prej $65 \pm 5^\circ\text{C}$ për një orë tjetër, si dhe duke e tundur lëngun kohë pas kohe. Përdorni raportin prej 100:1 mostër laboratorike-lëng. Largoni ujin e tepërt nga mostra duke e shtrydhur, thithur apo me anë të centrifugimit dhe pastaj lejo mostrat që të thahen në ajër.

Në rastin e elastolefinës ose përzierjet e fibrave që përmbajnë elastolefinë dhe fibra tjera (leshi, qimet e kafshëve, mëndafshi, pambuku, fijet e lirit (linë) të kërpit të vërtetë, jutë, abakë, alfa, Coir (fijet nga shtresa e jashtme e arrës së kokosit), fshesë, rami, Sizali, Kupro, modale, proteina, viskozë, akril, poliamide ose najlon, poliesteri, Elastomultiester) procedura e posa përshkruar do të modifikohet lehtësisht, ashtu që eteri i naftës së lehtë do të zëvendësohet me acetone.

Në rastin e përzierjeve të fibrave të dyfishta që përmbajnë elastolefinë dhe acetat, si trajtim paraprak do të aplikohet procedura e mëposhtme. Ekstraktimi mostrën laboratorike për 10 minuta në 80°C me një tretësirë që përmban 25 g/l të acidit ortofosforik 50% dhe 50 g/l të ure. Përdorni raportin mostër laboratorike-lëng prej 100:1. Pastroni mostrën laboratorike në ujë, pastaj lëreni të thahet dhe pastrojeni atë me tretësirë të bikarbonat natriumit 0,1%, dhe në fund pastrojeni me kujdes me ujë.

Kur nuk mund të ekstrahohet materia jo-fibroze me naftë të lehtë dhe ujë, ajo do të hiqet duke zëvendësuar në metodën e ujit të përshkruar më lart me një metodë e cila nuk e cenon në thelb ndonjërin prej përbërësve të fibrës. Megjithatë, për disa fibrave të pazbardhura, fibra bimore natyrore (p.sh. jutë, Coir) duhet të theksohet se trajtimi paraprak normal me naftë të lehtë dhe ujë nuk do të heqë të gjitha substancat natyrore jo-fibroze; megjithatë trajtimi paraprak shtesë nuk aplikohet përveç nëse mostra përmban produkte të patretshme si në naftën e lehtë ashtu edhe në ujë.

Raportet e analizave përfshijnë detaje të plota të metodave të përdorura të trajtimit paraprak.

I. 7. PROCEDURA E TESTIMIT

I.7.1. Udhëzime të përgjithshme



I.7.1.1. Tharja

Zhvillo të gjitha operacionet e tharjes jo më pak se 4 orë dhe jo më shumë se 16 orë në temperature prej $105\pm 3^{\circ}\text{C}$, në një furrë të ventiluar dhe me derën të mbyllur mirë. Nëse periudha e tharjes është më pak se 14 orë, mostra duhet të peshohet për të kontrolluar se masa e saj është bërë konstante. Masa mund të konsiderohet se është bërë konstante, pas një periudhe të mëtutjeshme të tharjes prej 60 minutash, ndryshimi i saj është më pak se 0,05%.

Keni kujdes të mos i prekni me duar pa dorëza korxholet dhe enët e peshimit, mostrat ose mbetjet gjatë procesit të tharjes, ftohjes dhe veprimeve të peshimit.

Thani mostrat përfaqësuese në një enë peshimi me kapakun e saj pranë saj. Pas tharjes, mbyllni enën e peshimit para se ta largoni atë nga furra, dhe pastaj transferoni atë shpejtë në eksikatorë.

Thani filtrin e enës për filtrim në një enë peshimi me kapakun e saj pranë saj në furrë. Pas tharjes, mbyllni enën e peshimit dhe barteni atë shpejt në eksikatorë.

Kur përdoren aparatura tjera përveç enës për filtrim, veprimet e tharjes në furrë kryhen në atë mënyrë që të mundësojnë përcaktimin e masës së tharë të fibrave pa humbje.

I.7.1.2. Ftohja

Kryej të gjitha veprimet e ftohjes në eksikatorë, kjo e fundit vendoset pranë peshores, deri kur të arrihet ftohja e plotë e enëve të peshimit dhe në çfarëdo shtate për jo më pak se 2 orë.

I.7.1.3. Peshimi

Pas ftohjes, kryeni peshimin e enës së peshimit brenda 2 minutave pas largimit të saj nga eksikatori. Peshoni deri në një saktësi prej 0,0002 g.

I.7.2. Procedura

Merrni nga mostra laboratorike e trajtuar paraprakisht një mostër përfaqësuese duke matur së paku 1g. Preni fijen ose pëlhurën në gjatësi prej 10 mm, copëtoni sa më shumë të jetë e mundur. Thani mostrën përfaqësuese në një enë peshimi, ftohni atë në eksikatorë



dhe peshojeni atë. Barteni mostrën përfaqësuese në epruvetë, siç specifikohet në pjesën përkatëse të metodës së Unionit, peshoni përsëri enën e peshimit menjëherë dhe fitoni masën e tharë të mostrës përfaqësuese me anë të ndryshimit. Plotësoni testin siç specifikohet në pjesën e duhur të metodës së zbatueshme. Ekzaminoni mbetjen me anë të mikroskopit për të parë nëse trajtimi me të vërtetë ka larguar fibrën e tretshme.

I. 8. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Paraqitni masën e komponentit të pa tretshëm si përqindje e masës së përgjithshme të fibrës në përzierje. Përqindja e komponentit të tretshëm përftohet nga ndryshimi. Llogarit rezultatet mbi bazën e masës së pastër dhe të thatë, të përshtatura sipas: (a) kufijve të lejuar dhe (b) faktorëve të nevojshëm korrigjues, për të marrë parasysh humbjen e materies gjatë trajtimit paraprak dhe analizës. Llogaritjet bëhen duke zbatuar formulën e dhënë në I.8.2.

I.8.1. Llogaritja e përqindjes së komponentit të patretshëm mbi bazën e masës së pastër dhe të thatë, duke mos marre për bazë humbjen e masës së fibrave gjatë trajtimit paraprak:

$$P_1\% = \frac{100 \text{ rd}}{m}$$

Ku,

$P_1\%$ është përqindja e komponentit të pa tretshëm të pastër dhe të thatë,

m është masa e thatë e mostrës përfaqësuese pas trajtimit paraprak,

r është masa e thatë e mbetjes,

d është faktori korrigjues për humbje në masën e komponentit të patretshëm në reagjent gjatë analizës. Vlerat e përshtatshme për ' d ' janë dhënë në pjesën përkatëse të secilës metodë.

Sigurisht, këto vlera për ' d ' janë vlerat normale të aplikueshme për fibra të pazbërthyeshme kimikisht.



I.8.2 Llogaritja e përqindjes së komponentit të pa tretshëm mbi bazën e një mase të pastër dhe të thatë, me rregullim nga ana e faktorëve konvencionale dhe kur është e përshtatshme, nga faktorët korrigjues për humbjen e masës gjatë trajtimit paraprak:

$$P_{1A}\% = \frac{100 P_1 \left(1 + \frac{a_1 + b_1}{100}\right)}{P_1 \left(1 + \frac{a_1 + b_1}{100}\right) + (100 - P_1) \left(1 + \frac{a_2 + b_2}{100}\right)}$$

Ku,

$P_{1A}\%$ është përqindja e komponentit të pa tretshëm të rregulluar me anë të lejimeve dhe për humbjen në masë gjatë trajtimit paraprak,

P_1 është përqindja e komponentit të pa tretshëm të pastër dhe të thatë, sipas llogaritjes nga formula që paraqitet në I.8.1,

a_1 është lejimi i dakorduar për komponentin e pa tretshëm (shih Shtojcën IX),

a_2 është lejimi i dakorduar për komponentin e tretshëm (shih Shtojcën IX),

b_1 është humbja e përqindjes së komponentit të pa tretshëm, të shkaktuar nga trajtimi paraprak,

b_2 është humbja e përqindjes së komponentit të tretshëm, të shkaktuar nga trajtimi paraprak.

Përqindja e komponentit të dytë është $P_{2A}\% = 100 - P_{1A}\%$.

Kur është përdorur një trajtim paraprak i veçantë, përcaktohen vlerat e b_1 dhe b_2 , nëse është e mundur, duke paraqitur secilin prej përbërësve të fibrës së pastër për trajtimin paraprak të aplikuar në analizë. Fibrat e pastra janë ato fibra që janë të lira nga të gjitha materialet jo-fibroze, përveç atyre që normalisht i përmbajnë (qoftë në mënyrë të natyrshme ose për shkak të procesit të prodhimit), në atë gjendje që janë gjetur në materialin që duhet analizuar (e pazbardhur, e zbardhur).

Kur nuk janë në dispozicion fibrat e komponentëve të ndara jo të pastra të cilat përdoren në prodhimin e materialeve që do të analizohen, atëherë përdoren vlerat mesatare të b_1 dhe b_2 të fituara nga testet e kryera në fibrat e pastra, të ngjashme me ato në përzierjen që është nën ekzaminim.



Aty ku fibrat jo të pastra përbërëse të përdorura në prodhimin e materialit që do të analizohen janë në dispozicion, do të përdoren vlerat mesatare të b₁ dhe b₂ të marra nga testet e kryera në fibrat e pastra të ngjashme me ato në përzierje në shqyrtim.

Nëse aplikohet trajtimi paraprak me anë të ekstraktimit me naftë të lehtë dhe ujë, faktorët korrigjues b₁ dhe b₂ mund të injorohen përgjithësisht, përveç në rastin e pambukut të pazbardhur, lirit të pazbardhur (ose linë) dhe kërpit të pazbardhur, ku humbja për shkak të trajtimit paraprak konvencionalisht merret si 4%, dhe në rastin e polipropilenit, ku është marrë si 1%.

Në rastin e fibrave të tjerë, humbjet për shkak të trajtimit paraprak, përgjithësisht nuk merren për bazë në llogaritje.

II. Metoda e analizës sasiore sipas ndarjes manuale

II. 1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme për fibrat e të gjitha llojeve të tekstilit, ato nuk formojnë përzierje të ngushtë, dhe se është e mundur që ato të ndahen me dorë.

II. 2. PARIMI

Pas identifikimit të përbërësve të tekstilit, materiali jo-fibroz largohet me një trajtim të përshtatshëm paraprak dhe pastaj fibrat ndahen me dorë, thahen dhe peshohen në mënyrë që të llogaritet përqindja e secilës fibër në përzierje.

II. 3. APARATURA

II.3.1. Ena për peshim ose ndonjë aparaturë tjetër e cila jep rezultate identike.

II.3.2. Eksikatori i cili përmban silikagel vetë tregues.

II.3.3. Furrë e ventiluar për tharjen e mostrave përfaqësuese në $105 \pm 3^{\circ}\text{C}$.

II.3.4. Peshore analitike, me saktësi prej 0,0002 g.

II.3.5. Ekstraktuesi “Soxhlet”, apo ndonjë aparaturë tjetër e cila jep rezultate identike.

II.3.6. Gjilpëra.



II.3.7. Mjeti për testimin e përdredhjes apo ndonjë aparaturë e ngjashme.

II. 4. REAGJENTËT

II.4.1. Nafta e lehtë, e ri-distiluar, me pikë vlimi prej 40 deri 60 °C.

II.4.2. Ujë i distiluar ose i dejonizuar.

II.4.3. Aceton.

II.4.4. Acid ortofosforik.

II.4.5. Ure.

II.4.6. Bikarbonat natriumi.

Të gjithë reagjentët e përdorur duhet të jenë kimikisht të pastër.

II. 5. PËRSHTATJA DHE RREGULLIMI I MJEDISIT PËR TESTIM

Shih I. 4.

II. 6. MOSTRA LABORATORIKE

Shih I. 5.

II. 7. TRAJTIMI PARAPRAK I MOSTRËS LABORATORIKE

Shih I. 6.

II. 8. PROCEDURA

II.8.1. Analiza e fijes



Nga mostra laboratorike e trajtuar paraprakisht zgjidhni një mostër përfaqësuese apo masë jo më të vogël se 1 g. Për një fije shumë të hollë, mund të bëhet analiza në gjatësi minimale prej 30 m pa marrë parasysh masën e saj.

Preni fijen në pjesë me gjatësi të përshtatshme dhe ndani llojet e fibrave me anë të një gjilpëre dhe nëse është e nevojshme, një mjet për testimin e përdredhjes. Llojet e fibrave të fituara kështu vendosen në enën laboratorike për peshim, të peshuar paraprakisht, dhe thahet në temperaturë prej $105 \pm 3^\circ\text{C}$, derisa sa të mos fitohet një masë konstante, siç është përshkruar në I.7.1 dhe I.7.2.

II.8.2. Analiza e pëlhurës

Nga mostra laboratorike e trajtuar paraprakisht zgjidhni, larg prej tegelave, një mostër përfaqësuese jo më të vogël se 1 g, me skaje të shkurtuara me kujdes, për të shmangur grisjen dhe duke prere paralelisht me fijet e pëlhurës apo bazës ose indit, ose në rastin e materialeve/stofave të thurur në drejtim me vegëzat e rreshtave dhe kolonave. Ndani llojet e ndryshme të fibrave, grumbulloni ato në enët laboratorike të peshimit, të peshuara paraprakisht, dhe vazhdoni sipas procedurës së përshkruar në II. 8.1.

II.9. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Paraqitni masën e secilit përbërës fibror si përqindje e masës së përgjithshme të fibrave në përzierje. Llogarisni rezultatet mbi bazën e një mase të pastër dhe të tharë, të rregulluar sipas (a) kufijve të dakorduar dhe (b) faktorëve korrigjues, të nevojshëm për të marrë parasysh humbjen e materies gjatë përpunimit paraprak.

II.9.1. Llogaritja e masave të përqindjes të fibrave të pastra dhe të thara, duke mos marrë parasysh humbjen e masës së fibrave gjatë trajtimit paraprak:

$$P_1\% = \frac{100 m_1}{m_1 + m_2} = \frac{100}{1 + \frac{m_2}{m_1}}$$

$P_1\%$ është përqindja e komponentës së parë të pastër dhe të tharë,

m_1 është masa e komponentës së parë të pastër dhe të tharë,

m_2 është masa e komponentës së dytë të pastër dhe të tharë.



II.9.2. Për llogaritjen e përqindjes së secilit komponent me rregullim sipas lejimeve të pajtuara dhe kur është e përshtatshme, sipas faktorëve korrigjues për humbjen e materies gjatë trajtimit paraparak, shih I. 8.2.

III. 1. SAKTËSIA E METODAVE

Saktësia e treguar në metodat e veçanta lidhet me riprodhueshmërinë.

Riprodhueshmëria i referohet besueshmërisë, d.m.th. afërsisë së pajtueshmërisë ndërmjet vlerave eksperimentale të fituara nga operatorët në laboratorë të ndryshëm ose në kohë të ndryshme, duke përdorur të njëjtën metodë, dhe nxjerrja e rezultateve individuale lidhur me mostër përfaqësuese të një përzierje identike dhe të njëtrajtshme.

Riprodhueshmëria shprehet me kufijtë e besueshmërisë së rezultateve për nivelin e besueshmërisë prej 95% .

Prandaj, dallimi në mes të dy rezultateve në një seri analizash të kryera në laboratorë të ndryshëm, në rast se aplikohet metodë normale dhe korrekte për një përzierje identike dhe homogjene, do të tejkalonte kufirin e besueshmërisë në pesë raste nga 100 sosh.

III. 2. RAPORTI I TESTIMIT

III.2.1. Paraqit se analiza e zhvilluar është në pajtim me këtë metodë.

III.2.2. Jepni detajet për ndonjë trajtim të veçantë paraparak. (shih pikën 1.6).

III.2.3. Jepni rezultatet individuale dhe mesataren aritmetike, secila me saktësi prej 0,1.



IV. Metodatat e veçanta

Tabela përmbledhëse

Metoda	Fusha e zbatimit		Reagjenti/Përshkrimi
	Komponent i tretshëm	Komponent i patretshëm	
1.	Acetati	Fibra të tjera të caktuara	Aceton
2.	Fibra të caktuara të proteinave	Fibra të tjera të caktuara	Hipokloruri
3.	Viskozë, fije mëndafshi dhe lloje të tjera modale	Fibra të tjera të caktuara	Acid formik dhe klorur zinku
4.	Poliamid ose najlon	Fibra të tjera të caktuara	Acid formik, 80 % m/m
5.	Acetati	Fibra të tjera të caktuara	Alkool benzilik
6.	Triacetate ose Polilaktide	Fibra të tjera të caktuara	Diklorometani
7.	Fibra të caktuara të celulozës	Fibra të tjera të caktuara	Acid sulfurik, 75 % m/m
8.	Akrikët, modakrikët e caktuar ose fibra klorure të caktuara	Fibra të tjera të caktuara	Dimetilformamidi
9.	Fibrat e caktuara klorure	Fibra të tjera të caktuara	Disulfidi i karbonit/acetoni, 55,5/44,5 % v/v
10.	Acetat	Fibra të tjera të caktuara	Acid acetik glacial
11.	Mëndafsh	Fibra të tjera të caktuara	Acid sulfurik, 75 % m/m
12.	Jutë	Fibra të tjera të caktuara	Metoda e përmbajtjes së



			nitrogjenit
13.	Polipropileni	Fibra të tjera të caktuara	Ksileni
14.	Fibra të tjera të caktuara	Fibra klorure (homopolimeret e klorurit të vinilit), elastolefina ose melamina	Acid sulfurik i përqendruar
15.	Fibrat klorure, modakrilikët e caktuar, elastanet e caktuara, acetatët, triacetatët	Fibra të tjera të caktuara	Cikloheksani
16.	Melamina	Pambuku ose aramidi	Acid formik i nxehtë, 90 % m/m

METODA Nr. 1

ACETATI DHE FIBRA TË TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me acetone)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibroze, për përzierjet e fibrave dyfishe:

1. acetat (19)
me

2. leshi (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafshi (4), pambuku (5), fjetet e lirit (ose linë) (6), kërpi i vërtetë (7), jutë (8), abakë (9), alfa (10), fibra kokosi/Coir (11), fshesa (12), rami-fibra të hithit (13), Sizali (14), fibrat nga bakri/Kupro (21), modale (22), proteina (23), viskoza (25), akril (26), poliamide ose najloni (30), poliesteri (35) Elastomultiesteri (45), elastolefina (46) dhe melamina (47).

Kjo metodë assesi nuk aplikohet në fibrat acetatë, të cilat kanë qenë të de-acetilizuara.



2. PARIMET

Acetati tretet nga masa e tharë e njohur e përzierjes, me aceton. Mbetja mblidhet, pastrohet, thahet dhe peshohet; nëse e është nevojshme masa e tyre korrigjohet, shprehet si përqindje e masës së tharë e përzierjes. Përqindja e fibrave acetatit të tharë llogaritet nga ndryshimi.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të përshkruar në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

Erlenmajer me tapë qelqi, me kapacitet prej së paku 200 ml.

3.2. Reagjentët

Acetoni.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim:

Në ekzemplar i cili ndodhet në Erlenmajer me tapë qelqi, të vëllimit prej së paku 200 ml, shtoni 100 ml aceton për gram të ekzemplarit të testimit, tundni enën e qelqit (erlenmajeri) dhe lëreni të qëndrojë në temperaturë të dhomës për 30 minuta, duke e përzier përmbajtjen kohë pas kohe, pastaj filtroni lëngun përmes enës së matur filtruese. Përsëritni procesin edhe dy herë (duke kryer kështu tri ekstrakte), mirëpo në periudha prej 15 minutave, ashtu që koha e përgjithshme e trajtimit në aceton të jetë një orë. Mbetja bartet në enën e filtrimit, pastrohet me aceton, dhe filtrohet me thithje/vakum. Rimbusheni enën për filtrim me aceton dhe lejoni të filtrohet me anë të gravitetit.

Në fund, filtroni enën për filtrim me vakum, thani enën për filtrim dhe mbetjen, pastaj ftohni atë dhe peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhen në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00, me përjashtim të melaminës, për të cilën vlera e 'd' është 1,01.



6. SAKTËSIA

Në një përzierje homogjene të fibrave të tekstilit, intervali i sigorisë së rezultateve të arritura me anë të kësaj metode, nuk janë më të mëdha se ± 1 të statistikave të sigurisë prej 95 % .

METODA Nr. 2

FIBRA PROTEINE TË CAKTUARA DHE FIBRA TË TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me hipoklorure)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibroze, në përzierjet e fibrave dyfishe:

1. fibra proteine të caktuara, përkatësisht: leshi (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafshi (4), proteina (23)

me

2. pambuk (5), fibra bakri/Kupro (21), modale (22), viskozë (25), akril (26), fibra klorure (27), Poliamid ose najlon (30), poliesther (35), polipropilen (37), elastan (43), fibër qelqi (44), Elastomultiester (45), elastolefinë (46) dhe melaminë (47).

Nëse në përzierje janë të pranishme fibra të tjera proteine, metoda jep totalin e shumave të tyre, mirëpo jo edhe sasi të tyre individuale.

2. PARIMET

Fibra proteine tretet nga përzierja e njohur e masës së tharë me tretësirë të hipoklorurit. Mbetja mbledhet, pastrohet, thahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet si përqindje e masës së tharë të përzierjes. Përqindja e fibrës së proteinës së tharë gjendet me anë të ndryshimit.

Për përgatitjen e tretësirës së hipoklorurit mund të përdoret ose hipokloruri i litiumit ose hipokloruri i natriumit.



Hipokloruri i litiumit rekomandohet në rastet ku përfshihet një numër të vogël i analizave, apo për analizat që kryhen në intervale të gjata. Kjo për arsyeje se pjesëmarrja e hipoklorurit në hipoklorurin e litiumit të ngurtë, për dallim nga hipokloruri i natriumit, është pothuajse konstant. Nëse përqindja e hipoklorurit është e njohur, përmbajtja e hipoklorurit nuk është e nevojshme të vërtetohet me metodën jodometrike për secilën analizë, pasi që mund të shfrytëzohet pjesa e peshuar e hipoklorurit të litiumit.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të përshkruara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

- (a) Erlenmajeri me tapë qelqi, me kapacitet prej 250 ml.
- (b) Termostati, i rregullueshëm në temperaturë 20 ± 2 °C.

3.2. Reagjentët

(a) Reagjent i hipoklorurit

(i) Tretësira e hipoklorurit të litiumit

Kjo përbëhet nga tretësira e përgatitur e freskët, e cila përmban 35 ± 2 g/l të klorit aktiv (përafërsisht 1 M), të cilës i shtohet $5 \pm 0,5$ g/l të hidroksidit të natriumit të tretur paraprakisht. Për përgatitje, treni 100 gram hipoklorur të litiumit i cili përmban 35% klor aktivë (apo 115 gram që përmban 30% të klorit aktiv) në afërsisht 700 ml ujë të distiluar, i shtoni 5 gram hidroksid natriumi të tretur në afërsisht 200 ml ujë të distiluar, dhe plotësojeni tretësirën e përbashkët me ujë të distiluar për të arritur 1 litër. Kjo tretësirë e cila sapo është përgatitur nuk është e nevojshme të vërtetohet me metodën jodometrike.

(ii) Tretësira e hipoklorurit të natriumit

Kjo përbëhet nga tretësira e përgatitur e freskët, e cila përmban 35 ± 2 g/l të klorit aktiv (përafërsisht 1 M), të cilës i është shtuar $5 \pm 0,5$ g/l hidroksidi i natriumit të tretur paraprakisht.

Para çdo analize, kontrolloni përmbajtjen e klorit aktiv të tretësirës me anë të metodës jodometrike.



(b) Acidi acetik, tretësirë e holluar

Holloni 5 ml të acidit acetik glacial me 1 litër ujë.

4. PROCEDURA E TESTITIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim: Përzini afërsisht 1 gram të ekzemplarit të testimit me afërsisht 100 ml tretësirë të hipoklorurit (të litiumit apo natriumit) në enën e qelqit (erlenmajeri) me vëllim prej 250 ml dhe tundni mirë atë, ashtu që mostra të laget e tëra.

Pastaj ngrohni enën për 40 minuta në temperaturë prej 20 °C duke e tundur vazhdimisht, ose së paku në intervale të rregullta. Meqë tretja e leshit zhvillohet në mënyrë ekzotermike, nxehtësia e liruar gjatë reaksionit duhet të shpërndahet dhe largohet. Përndryshe mund të shkaktohen gabime të konsiderueshme për shkak të tretjes fillestare të fibrave të pa tretshme.

Pas 40 minutash, filtroni përmbajtjen e enës përmes enës filtruese të qelqit të matshme, dhe transferoni të gjitha mbetjet e fibrave në enën për filtrim duke e shpërlarë enën (erlenmajeri) me pak reagjent të hipoklorurit. Zbrazni enën e filtrimit me anë të vakumit dhe shpërlani mbetjen në mënyrë të njëpasnjëshme me ujë, holloni acidin acetik dhe në fund ujin, duke zbrazur enën e filtrimit me anë të thithjes pas secilit shtim. Mos aplikoni thithjen me vakum deri sa secili lëng i shpëlarjes të mos jetë kulluar me anë të gravitetit.

Në fund, kulloni enën e filtrimit me anë të thithjes me vakum, thani enën e matjes me mbetje dhe ftohni atë, pastaj peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00, përveç pambukut, viskozës dhe modaleve, për të cilat 'd' është 1,01, si dhe për pambukun e pazbardhur 'd' e të cilës është 1,03.

6. SAKTËSIA

Në përzierjet homogjene të fibrave të tekstilit, kufijtë e besueshmërisë për rezultatet e fituara me anë të kësaj metode, nuk janë më të mëdha se ± 1 për nivelin e besueshmërisë prej 95 %.

METODA Nr. 3



FIBRAT VISKOZE, FIBRAT E BAKRIT (CUPRO) OSE LLOJET E CAKTUARA TË FIBRAVE MODALE DHE FIBRA TJERA

(Metoda me acid formik dhe klorur zinku)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materieve jo fibroze, për përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. viskozës (25) apo fibra të bakrit (kupro) (21), duke përfshirë edhe disa lloje të caktuara të fibrave modale (22) me
2. pambuk (5), elastolefinë (46) dhe melaminë (47).

Nëse konstatohet prania e fibrave modale, është e nevojshme të kryhet testimi paraprak për të vërtetuar se a është fibra e tretshme në reagjent. Kjo metodë nuk është e aplikueshme për përzierjet në të cilat pambuku ka përjetuar degradim të madh kimik e as kur viskoza apo fibrat e bakrit të cilat nuk janë tërësisht të tretshëm nga prania e ngjyrave të caktuara ose mjetet e finalizimit, të cilat nuk mund të largohen plotësisht.

2. PARIMET

Viskoza, fibrat e bakrit apo fibrat modale treten nga masa e njohur e tharë e përzierjes me reagjent i cili përbehet nga acidi formik dhe kloruri i zinkut. Mbetja mblidhet, lahet, thahet dhe peshohet; nëse është e nevojshme, masa e korigjuar e saj shprehet si përqindje e përzierjes së masës së tharë. Përqindja e fibrës së tharë të viskozës, bakrit apo fibrës modale vërtetohet me ndihmën e ndryshimit.

3. APARATURA DHE REAGEJNTËT (përveç atyre të specifikuar në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

- (a) Ena laboratorike e qelqit me formë konike (Erlenmajeri) me kapacitet prej së paku 200 ml.
- (b) Aparatura për mbajtjen e enës laboratorike në temperaturë prej 40 ± 2 °C.



3.2. Reagentët

- (a) Tretësira e cila përmban 20 gram të klorurit të zinkut anhidrik dhe 68 g të acidit formik anhidrik, i cili krijohet deri në 100g me ujë (përkatesisht 20 pjesë të masës të tretur të klorurit të zinkut anhidrik në 80 pjesë të masës prej 85% m/m të acidit formik).

Shënim:

Në këtë drejtim, tërhiqet vëmendja në pikën I.3.2.2, e cila parasheh se të gjithë reagentët e përdorur duhet të jenë kimikisht të pastër; është esenciale që të përdoret kloruri i zinkut anhidrik.

- (b) Tretësira e hidroksidit të amonit; holloni me ujë 20 ml të tretësirës së amonit të përqendruar (me densitet relativ prej 0,880 g/ml, në temperaturë prej 20 °C) deri në 1 litër.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme, dhe vazhdoni si në vijim: vendosni ekzemplar për testim në enë laboratorike (erlenmajer) të ngrohur paraprakisht në temperaturë prej 40 °C. Shtoni 100 ml të tretësirës së acidit formik dhe klorurit të zinkut për gram të ekzemplarit mostër, të ngrohur paraprakisht në temperaturë prej 40 °C. Ena mbyllet me tapë dhe tundet vullshëm. Mbani enë laboratorike dhe përbërësit në të në temperaturë konstante prej 40 °C për 2,5 orë, duke e tundur enën në intervale prej një ore. Filtroni përmbajtjen e enës laboratorike përmes enës filtruese të peshuar dhe me ndihmën e reagentit transferoni në enë e filtrimit çdo fibër të mbetur në enë laboratorike (erlenmajer). Shpërlani përmbajtjen me 20 ml reagent të ngrohur paraprakisht në temperaturë prej 40 °C. Lani enën e filtrimit dhe mbetjet tërësisht, me ujë në temperaturë prej 40 °C. Shpërlani mbetjet fibroze me afërsisht 100 ml tretësirë amoniakale të ftohtë (3.2 (b)), duke siguruar që kjo mbetje të mbetet tërësisht e zhytur në tretësirë për 10 minuta (⁸); pastaj shpërlani atë mirë e mirë me ujë të ftohtë. Mos e aplikoni thithjen nën vakum, deri sa secili lëng i shpëlarjes të mos kullohet me gravitet. Në fund, kulloni lëngun e mbetur me thithje nën vakum, thani enën e filtrimit dhe mbetjen së bashku, ftohni ato dhe peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' për pambukun është 1,02 , për melaminë është 1,01 dhe për elastolefinën 1,00.



6. SAKTËSIA

Në përzierjen homogjene të materialeve të tekstilit, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara përmes kësaj metode nuk janë më të mëdha se ± 2 për nivelin e besueshmërisë 95 %.

METODA Nr. 4

FIBRAT POLIAMIDE OSE NAJLONI, DHE FIBRAT TJERË TË CAKTUAR

(Metoda e cila përdor acidin formik 80% m/m)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materieve jo fibroze, për përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. Fibrat poliamide ose najloni (30)

me

2.lesh (1), qime kafshësh (2 dhe 3), pambuk (5), fibra bakri (Kupro) (21), modale (22) viskozë (25), akril (26), fibra klori (27), poliestër (35), polipropilen (37), fibra qelqi (44), Elastomultiester (45), elastolefinë (46) dhe melaminë (47).

Siç u përmend më lartë, kjo metodë gjithashtu aplikohet në përzierjet me lesh, mirëpo kur përmbajtja e leshit tejkalon 25%, duhet të aplikohet metoda Nr. 2 (tretja e leshit në tretësirën e hipoklorurit të natriumit apo të litiumit).

2. PARIMET

Fibrat poliamide apo najloni treten në acidin formik nga një masë e njohur dhe e tharë e përzierjes. Mbetja mblidhet, pastrohet, thahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet si përqindje e masës së tharë të përzierjes. Përqindja e tharë e poliamidit llogaritet me anë të ndryshimit.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të përshkruara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura



Ena laboratorike në formë konike me tapë qelqi (erlenmajeri), me kapacitet prej së paku 200 ml.

3.2. Reagjentët

- (a) Acidi formik me përqendrim 80% m/m, (me dendësi relative 1,186, në temperaturën prej 20 °C). Holloni në ujë 880 ml të acidit formik me përqendrim 90% m/m (me dendësi relative 1,204, në temperaturën prej 20 °C) deri në 1 litër. Mundësia tjetër është, holloni në ujë 780 ml të acidit formik me përqendrim nga 98 deri në 100% m/m (me dendësi relative 1,220, në temperaturën prej 20 °C) deri në 1 litër.

Përqendrimi nuk është kritik brenda intervalit 77 deri në 83% m/m të acidit formik.

- (b) Amoni, tretësirë e holluar: holloni në ujë 80 ml të tretësirës së përqendruar amoniakale (me dendësi relative 0,880, në temperaturën prej 20 °C) deri në 1 litër.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqu procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim: në ekzemplar për testim, i cili gjendet në enë laboratorike (erlenmajer) me kapacitet prej së paku 200 ml, shtoni 100 ml të acidit formik për gram të ekzemplarit/mostrës. Vendosni tapën dhe tundni enën për të lagur ekzemplar/mostrën. Vendosni enën mbi tavolinën e punës të qëndrojnë për 15 min në temperaturë të dhomës, duke e përzier atë në intervale kohore. Filtroni përmbajtjen e enës nëpër enë filtruese të peshuar, si dhe transferoni fibrat tjera të mbetura në enë e filtrimit duke e larë atë me pak reagjent të acidit formik.

Kulloni enën e filtrimit me anë të thithjes në vakum dhe pastroni mbetjen në filtër kohë pas kohe me reagjent acid formik, me ujë të nxehtë, me tretësirë të holluar amoniakale, dhe në fund me ujë të ftohtë, kulloni enën e filtrimit me anë të thithjes në vakum pas secilës tretësirë të shtuar. Mos aplikoni thithjen në vakum, deri sa mos të kullohet secili lëng i pastrimit me anë të gravitet.

Në fund kulloni enën e filtrimit me anë të thithjes në vakum, thani enën e filtrimit dhe mbetjen, pastaj ftohni ato dhe në fund peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00, me përjashtim të melaminës që ka vlerë të 'd' = 1,01.



6. SAKTËSIA

Për përzierjet homogjene të fibrave të tekstilit, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të arritura me anë të kësaj metode, nuk janë më të mëdha se ± 1 për nivelin e besueshmërisë prej 95 % .

METODA Nr. 5

FIBRAT E ACETATIT DHE FIBRAT TJERË TË CAKTUARA

(Metoda e cila përdor alkoolin benzilik)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materieve jo fibroze, për përzierjet dyfishe të:

1. Fibrave të acetatit (19)
me
2. Fibra triacetate (24), elastolefinën (46) dhe melaminën (47).

2. PARIMET

Fibra acetat tretet nga masa e tharë e njohur e përzierjes me alkool benzilik, në temperaturë prej 52 ± 2 °C.

Mbetja mblidhet, pastrohet, thahet dhe peshohet; masa e saj shprehet si përqindje e përzierjes së masës së tharë. Përqindja e acetatit të tharë vërtetohet me anë të ndryshimit.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të përshkruara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

- (a) Ena laboratorike (erlenmajeri) me kapacitet prej së paku 200 ml.
- (b) Përzierësja mekanike.



(c) Termostati apo ose ndonjë aparaturë tjetër për mbajtjen e enës laboratorike (erlenmajerin) në temperaturë prej 52 ± 2 °C.

3.2. Reagjentët

(a) Alkool benzilik.

(b) Etanol.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim:

Në ekzemplarin/mostrën e cila ndodhet në enën laboratorike (erlenmajer) shtoni 100 ml alkool benzilik për një gram të mostrës. Vendosni tapën, fiksoni erlenmajerin për përzierje ashtu që të jetë e zhytur në banjën e ujit e cila ka temperaturën prej 52 ± 2 °C, dhe tundet për 20 minuta në këtë temperaturë.

(Në vend të përdorimit të përzierëses mekanike, erlenmajeri mund të tundet edhe me dorë në mënyrë të vrullshme).

Kulloni lëngun nëpër enën filtruese të peshuar. Shtoni në erlenmajer edhe një dozë shtesë të alkoolit benzilik dhe tundni atë në temperaturë prej 52 ± 2 °C për 20 minuta. Kulloni pastaj lëngun nëpër enën e filtrimit. Përsëritni këtë cikël të veprimeve për të tretën herë.

Në fund, derdhni lëngun dhe mbetjen në enën e filtrimit; pastroni ndonjë fibër të mbetur nga erlenmajeri në enën e filtrimit me një sasi shtesë të alkoolit benzilik, në temperaturë prej 52 ± 2 °C. Kulloni mirë enën e filtrimit.

Transferoni fibrat në erlenmajer, shpërlani atë me etanol dhe pas tundjes në mënyrë manuale, kulloni atë përzierje nëpër enën e filtrimit.

Përsëritni këtë veprim të shpëlarjes dy apo tri herë të tjera. Transferoni mbetjen në enën e filtrimit dhe kullojeni atë mirë. Thani enën e filtrimit dhe mbetjen, dhe pastaj ftoheni atë dhe në fund e peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE



Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00, përveç melaminës e cila e ka 'd' = 1,01.

6. SAKTËSIA

Në përzierjet homogjene të materialeve të tekstilit, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara me anë të kësaj metode, nuk janë më të mëdha se ± 1 për nivelin e besueshmërisë prej 95 %.

METODA Nr. 6

TREACETATET OSE POLIAKTIDET DHE FIBRAT TJERË TË CAKTUAR

(Metoda me përdorim të diklormetanit)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materieve jo fibroze, për përzierjet dyfishe të:

1. treacetateve (24) ose polilaktideve (34)
me

2. lesh (1), qime kafshësh (2 dhe 3), mëndafsh (4), pambuk (5), fibra bakri-kupro (21), modale (22), viskozë (25), akril (26), poliamide ose najlon (30), poliester (35), fibra qelqi (44), elastomultiester (45), elastolefinë (46) dhe melaminë (47).

Shënim:

Fibrat triacetate të cilat iu kanë nënshtruar finalizimit, që krijon në situatën e hidrolizës së pjesshme, e që duhet tretur plotësisht në reagjent. Në raste të tilla, kjo metodë nuk është e aplikueshme.

2. PARIMET

Fibrat triacetate ose polilaktide treten nga masa e tharë e njohur e përzierjes me diklorometan. Mbetja mblidhet, pastrohet, thahet dhe peshohet; masa e tyre, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet si përqindje e masës së tharë të përzierjes. Përqindja e tharë e fibrave triacetate gjendet me anë të ndryshimit.



3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të përshkruara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

Ena laboratorike prej qelqi, me formë konike (erlenmajeri) me kapacitet prej së paku 200 ml.

3.2. Reagjenti

Diklorometani.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme, dhe vazhdoni si në vijim: Ekzemplari për testim/mostra vendoset në erlenmajerin me vëllim prej 200 ml, i shtohet 100 ml diklorometan për gram të mostrës, vendosni tapën, tundni enën për te lagur mostrën dhe leni të qëndrojë për 30 min në temperaturë dhome, duke e tundur enën çdo 10 minuta. Kulloni lëngun nëpër enën e matur për filtrim. Shtoni 60 ml. Diklorometani ne erlenmajeri ne të cilën ndodhet mbetja, tunde atë me dorë dhe filtroni përmbajtjen e enës nëpër enën për filtrim. Fibrat e mbetura barten në enë duke shpërlarë enën me më tepër diklorometan. Kulloni enën e filtrimit me thithje nën vakum për të larguar lëngun e tepërt, rimbusheni atë prapë me diklorometan dhe lëreni që të kullohet me anë të gravitetit.

Në fund, aplikoni thithjen nën vakum për të eliminuar lëngun e tepërt dhe pastaj trajtoni mbetjen me ujë të nxehtë për të eliminuar të gjithë tretësin, aplikoni thithjen nën vakum, thani enën e filtrimit dhe mbetjen, ftoheni atë dhe në fund peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00, përveç për fibrave poliestere, elastomultiestere, elastolefinës dhe melaminës, për të cilat vlera e 'd' është 1,01.

6. SAKTËSIA

Në përzierjen homogjene të materialeve të tekstilit, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara me anë të kësaj metode, nuk janë më të mëdha se ± 1 për nivelin e besueshmërisë 95 %.

METODA Nr. 7



FIBRAT E CAKTUARA TË CELULOZËS DHE FIBRA TJERA TË CAKTUARA

(Metoda e cila përdor 75% m/m të acidit sulfurik)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë aplikohet pas largimit të materieve jo fibroze, nga përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. pambukut (5), lirit (ose prej liri) (7), kërpit (8), fibra e Ramie (14), kupro (21), modale(22), viskozës (25) me
2. poliestër (35), elastomultiester (45) dhe elastolefinë (46).

2. PARIMET

Fibra celuloze tretet nga masa e tharë e përzierjes me 75% m/m acid sulfurik të koncentruar. Mbetja mblidhet, pastrohen, thahet dhe peshohet; masa e tyre shprehet si përqindje e masës së tharë të përzierjes. Përqindja e tharë e fibrave celuloze gjendet përmes ndryshimit.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të përshkruara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

- (a) Erlenmajeri me kapacitet prej së paku 500 ml.
- (b) Termostati apo aparaturat tjera për ruajtjen e temperaturës prej 50 ± 5 °C.

3.2. Reagjentët

- (a) Acid sulfurik, 75 ± 2 % m/m

Përgatitet me kujdes, përmes ftohjes, 700 ml të acidit sulfurik (me dendësi relative 1,84 prej 20 °C:) në 350 ml ujë të distiluar.

Pasi që tretja të ftohet në temperaturë të dhomës, hollohet me ujë deri 1 litër.



(b) Tretja e holluar e amoniakut

80 ml. të tretjes së amoniakut (dendësi relative në 20 ° C: 0,880) hollohet me ujë deri 1 litër.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim:

Mostra vendoset në erlenmajer me kapacitet prej së paku 500 ml, i shtohet 200 ml acidit sulfurik 75% për gram të mostrës, ena mbyllet, me kujdes tundet deri sa të laget mirë mostra. Ena futet në vaskën me ujë e cila e mbanë temperaturën prej 50 ± 5 °C për një orë, duke e tundur kohë pas kohe në interval prej 10 minutash. Përmbajta e enës filtrohet përmes enës filtruese matëse me acid sulfurik 75%.

Lëngu kullohet nga ena dhe mbetjet shpërlahen, filtrohen duke mbush enën me acid sulfurik të freskët. Nuk shfrytëzohet thithësja me vakum deri sa acidi nuk rrjedh lirshëm.

Mbetja pastrohet së pari me ujë të ftohtë, pastaj dy herë me tretjen e holluar të amoniakut, dhe pastaj me kujdes me ujë të ftohtë. Çdo shtesë e tretjes nga ena largohet me anë të thithëses. Nuk shfrytëzohet thithësja me vakum deri sa tretja për shpëlarje nuk rrjedh lirshëm. Në fund mbetja e lëngut nga ena largohet me thithësen me vakum, ena me mbetje thahet, ftohet dhe matet.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogarit rezultatet siç janë përshkruar në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00.

6. SAKTËSIA

Në një përzierje homogjene të materialeve tekstile, kufijtë e besimit të rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për një nivel besueshmërie prej 95%.

METODA Nr. 8



AKRILI, MODAKRILET E NDRYSHME OSE DISA KLOOROFIBRA DHE FIBRA TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me përdorim të dimetilformamidit)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibrore, në përzierjen e fibrave dyfishe të :

1. Akril (26), modakrilet e caktuar (29), ose fibrat e caktuara klorure (27) ⁽⁹⁾

me

2. lesh (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafsh (4), pambuk (5), kupro (21), modale (22), viskozë (25), poliamide ose najlon (30), poliestere (35), elastomultiester (45), elastolefinë (46) dhe melaminë (47).

Është po aq i zbatueshëm për akrile dhe modakrile të caktuara, trajtohen me ngjyra të para-metalizuara, por jo për ato të ngjyrosura me ngjyra pas-kromimit.

2. PARIMET

Akrili, modakrili ose fibrat klorure treten nga një përzierje e njohur e masës së thatë me dimetilformamidi të ngrohur deri në pikën e vlimit në banjë uji. Mbetja mblidhet, lahet, thahet dhe peshohet. Masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, është e shprehur si përqindje e masës së përzierjes së thatë dhe përqindja e akrilit të thatë, modakrili, ose fibrat klorure gjendet nga ndryshimi.

3. APARATURAT DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparaturat

(a) Ene laboratorik me forme konike (erlenmajer), me kapacitet prej së paku 200 ml.

(b) Banjë uji në pikë vlimi.

3.2. Reagjenti

Dimetilformamidi (pika e vlimit 153 ± 1 °C) që nuk duhet të përmbaj ujë më shumë se 0,1 % .



Ky reagjent është toksik, prandaj rekomandohet mbajtja e maskës mbrojtëse.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si më poshtë:

Në mostrën që ndodhet në erlenmajerin me kapacitetit prej së paku 200 ml, shtoni për çdo gram të mostrës 80ml të dimetilformamidit, të ngrohur paraprakisht në banjën e ujit në pikën e vlimit, vendosni tapën, tundeni erlenmajerin që të laget mostra tërësisht dhe ngroheni në banjën e ujit në pikën e vlimit për një orë. Gjatë kësaj kohe tundni shishen dhe përmbajtjen e saj me dorë pesë herë gjatë kësaj periudhe kohore.

Filtroni lëngun përmes enës për filtrim të peshuar, duke i mbajtur fibrat në këtë enë. I shtoni shishes 60 ml dimetilformamidi dhe nxeheni edhe për 30 minuta tjera, duke e tundur dy herë shishen lehtë me dorë gjatë kësaj kohe.

Filtroni përmbajtjen nëpër enën e peshuar për filtruese me anë të thithjes me vakum.

Transferoni fibrat e mbetura në enën për filtrim duke i pastruar mbetjet me dimetilformamid. Kulloni enën për filtrim me thithje. Lajeni tepicën me afërsisht 1 litër ujë të nxehtë në 70-80 °C, duke mbushur enën për filtrim secilën herë.

Pas çdo shtimi të ujit, shkurtimisht aplikoni thithjen por jo derisa uji të mos jetë shteruar në bazë të gravitetit. Nëse lëngu për pastrim kullohet shumë ngadalë nëpër enën për filtrim, mund të aplikohet thithja e lehtë me vakum.

Në fund thajeni enën për filtrim me mbetjet, ftohni atë dhe peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç janë përshkruar në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00 përveç në rastin e leshtit, pambukut, fibrat e bakrit, poliestërit, elastomultiesterit dhe melaminës, për të cilat vlera e 'd' është 1.01.



6. SAKTËSIA

Në një përzierje homogjene të materialeve tekstile, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për një nivel besueshmërie prej 95%.

METODA Nr. 9

KLOROFIBRA TË CAKTUARA DHE FIBRA TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me përdorim të përzierjes së disulfurit të karbonit dhe acetonit 55,5/44,5% v/v)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibrore, në përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. Fibrat klorure të caktuara (27), përkatësisht disa fibra të klorur-polivinilit, qoftë klorinizuara pastaj apo jo ⁽¹⁰⁾
me

2. Lesh(1), qime të kafshëve (2 dhe 3), mëndafsh (4), pambuk (5), fibra bakri (21), modale (22), viskozë (25), akril (26), poliamide ose najlon (30), poliesther (35), fibra qelqi (44), Elastomultiesteri (45) dhe melaminë (47).

Kur përmbajtja e leshit ose mëndafshit tejkalon 25%, atëherë përdoret metoda Nr. 2.

2. PARIMET

Fibrat klorure treten nga një përzierje e thatë e masës, me një përzierje azeotropike të disulfurit të karbonit dhe acetonit. Mbetja mblidhet, lahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet si përqindje e masës së thatë të përzierjes. Përqindja e fibrës së thatë të klorur-polivinilit gjendet nga ndryshimi.

3. APARATURAT DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

(a) Erlenmajeri me kapacitet prej së paku 200 ml.



(b) Përzierëse mekanike.

3.2. Reagjentët

(a) Përzierje azeotropike e disulfurit të karbonit dhe acetone (vëllimi i disulfurit të karbonit 55,5 % me acetone 44,5 %). Pasi që ky reagjent është toksik, rekomandohet përdorimi i maskës mbrojtëse.

(b) Etanoli (me përqendrim 92 % sipas vëllimit) ose metanoli.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqu procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim:

Në mostrën që ndodhet në erlenmajerin me kapacitetin prej së paku 200 ml, shtoni 100 ml të përzierjes azeotropike për çdo gram të mostrës. Mbylleni erlenmajerin mirë, dhe tundeni për 20 minuta në përzierësin mekanik ose vrullshëm me dorë, në temperaturë të dhomës.

Filtroni lëngun që noton në sipërfaqe nëpër enën e peshuar për filtrim.

Përsëritni trajtimin me 100 ml të reagjentit të freskët. Vazhdoni këtë cikël të operacioneve derisa asnjë mbetje polimeri nuk është lënë në enë kur avullohet ekstrakti i lëngshëm. Transferoni mbetjet në enën për filtrim të peshuar duke përdorur më shumë reagjent, aplikoni thithjen për të larguar lëngun, shpërlajini enën për filtrim dhe mbetjet me 20 ml alkool dhe tri herë me ujë. Lejoni lëngun e pastruar të thahet në bazë të gravitetit para se të thahet me thithje. Thajeni enën për filtrim dhe mbetjet, ftohni atë dhe peshoni.

Shënim:

Me përzierjet e caktuara që kanë përmbajtje të lartë të fibrave klorure mund të ketë një tkurrje të konsiderueshme të mostrës gjatë procedurës së tharjes, si rezultat i së cilës tretja e fibrës klorure nga tretësi është e ngadalshme.

Megjithatë, kjo nuk do të ndikojë në tretjen përfundimtare të fibrës klorure në tretës.



5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e ‘d’ është 1,00, përveç melaminës, për të cilën ‘d’ është 1,01.

6. SAKTËSIA

Në një përzierje homogjene të materialeve tekstile, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për një nivel besueshmërie prej 95%.

METODA Nr. 10

FIBRAT ACETATE DHE FIBRAT TJERA TË CAKTUARA

(Metoda duke përdorur acidin acetik glacial)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibroze, në përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. acetatit (19)
me
2. Fibra klorure të caktuara (27), përkatësisht fibrat e klorurit të polivinilit, qoftë të klorinizuara pastaj ose jo, elastolefinë (46) dhe melaminë (47).

2. PARIMET

Fibrat acetat treten nga masa e tharë e përzierjes, me acid acetik glacial. Mbetja mblidhet, pastrohet, thahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet si përqindje e masës së tharë të përzierjes. Përqindja e acetatit të tharë gjendet nga ndryshimi.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuara në udhëzimet e përgjithshme)



3.1. Aparatura

(a) Erlenmajer me kapacitet prej së paku 200 ml.

(b) Përzierëse mekanike.

3.2. Reagjenti

Acidi acetik glacial (me përqendrim mbi 99 %). Ky reagjent duhet të trajtohet me kujdes pasi që është hidroksid i fortë.

4. PROCEDURA TESTIMIT

Ndiqu procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim:

Në mostrën që ndodhet në erlenmajer të kapacitetit prej së paku 200 ml, i shtoni 100 ml acid acetik glacial për gram të mostrës. Mbylleni mirë dhe tundeni për 20 minuta në përzierësin mekanik ose vrullshëm me dorë, në temperaturë të dhomës. Kullojeni lëngun pluskues në enën e peshuar për filtrim. Përsëritni këtë trajtim dy herë, duke përdorur 100 ml të reagjentit të freskët, duke bërë tri ekstrakte në përgjithësi.

Transferoni mbetjet në enën për filtrim, thajeni me thithje për të larguar lëngun dhe shpërlajeni enën për filtrim dhe mbetjet me 50ml acid acetik glacial, dhe pastaj tri herë me ujë. Pas çdo shpëlarjeje, lejoni lëngun të thahet nga graviteti para se të aplikoni thithjen nën vakum. Thajeni enën për filtrim dhe mbetjen, ftohni atë dhe peshoji.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç janë përshkruar në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00.

6. SAKTËSIA

Në një përzierje homogjene të materialeve tekstile, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për një nivel besueshmërie prej 95%.

METODA Nr. 11



MËNDAFSHI OSE POLIAMIDI DHE FIBRAT TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me përdorim të acidit sulfurik 75 % m/m)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibrore, në përzierjet e fibrave dyfishe/dykomponetëshe të:

1. Mëndafsh (4)
me
2. Lesh (1), qime të kafshëve (2 dhe 3), elastolefinë (46) dhe melaminë (47).

2. PARIMET

Fibra e mëndafshit tretet nga masa e thatë e përzierjes, me acidit sulfurik 75% m/m ⁽¹¹⁾.

Mbetja mblidhet, lahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet në përqindje e masës së tharë të përzierjes. Përqindja e mëndafshit të tharë gjendet nga ndryshimi.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

Erlenmajer me kapacitet prej së paku 200 ml.

3.2. Reagjentët

(a) Acid sulfurik (75 ± 2 % m/m)

Përgatiteni duke i shtuar me kujdes, në të ftohtë, 700 ml acid sulfurik (dendësia relative prej 1,84 , në 20 °C) në 350 ml ujë.

Pas ftohjes në temperaturën e dhomës, tretëni në një 1 litër me ujë.

(b)Acidi sulfurik, tretësira: shtoni ngadalë 100 ml acid sulfurik (dendësia relative e të cilit është 1,84, në 20 °C) në 1 900 ml ujë.



(c) Amoni, tretësira e tretur: tretni 200 ml të amonit të përqendruar (dendësia relative e të cilit është 0,880, në 20 °C) në një 1 litër me ujë.

4. PROCEDURA TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim:

Në mostrën që ndodhet në erlenmayerin me kapacitetit prej së paku 200 ml, shtoni 100 ml të acidit sulfurik 75% m/m për gram të mostrës dhe vendosni tapën. Tundeni vrellshëm dhe lëreni të qëndrojnë në temperaturë të dhomës për 30 minuta. Tundeni sërish dhe të lëreni të qëndrojnë për 30 minuta.

Tundeni për të fundit herë dhe filtroni përmbajtjen e erlenmayerit nëpër enën e peshuar për filtrim. Lajini fibrat e mbetura nga ena me reagjent të acidit sulfurik 75%. Lajini mbetjet në enën për filtrim radhazi me 50ml tretje të reagjentit acidit sulfurik, 50ml ujë dh 50ml tretësirë të amoniakut. Lejoni fibrat që çdo herë të jenë në kontakt me lëngun për 10 minuta para se të aplikoni thithjen. Në fund shpërlajeni me ujë, duke i lënë fibrat në kontakt me ujin për rreth 30 minuta.

Thajeni enën për filtrim me thithje, thajeni enën për filtrim dhe mbetjet, ftohe dhe peshoje.

5. LLOGARITJA DHE PASQYRIMI REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç janë përshkruar në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 0,985 për lesh, 1,00 për elastolefinë dhe 1,01 për melaminë.

6. SAKTËSIA

Në një përzierje homogjene të materialeve tekstile, kufijtë e besimit të rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për një nivel besueshmërie prej 95%.

METODA Nr. 12

JUTA DHE FIBRA SHTAZORE TË CAKTUARA

(Metoda me përcaktimin e përmbajtjes së azotit)



1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibrore, për përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. jutës (9)
me
2. Fibra shtazore të caktuara.

Komponenti i fibrave shtazore mund të përbëhet kryesisht nga qimet (2 dhe 3) ose leshi (1), apo nga përzierja e të dyjave. Kjo metodë nuk aplikohet tek përzierjet e tekstilit me përmbajtje jo-fibrore (ngjyrosjet, finalizimet, etj.) me bazë azotike.

2. PARIMET

Përmbajtja e përzierjes së azotit është e përcaktuar, nga kjo llogaritet përqindja e secilit komponent dhe përmbajtja e njohur apo e supozuar e përmbajtjes së azotit e dy komponentëve.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

- (a) Enë normale për tretje Kjeldahl, e kapacitetit prej 200-300 ml.
- (b) Aparatura e distilimit Kjeldahl.
- (c) Aparatura e titrimit, e cila ka precizitet prej 0,05 ml.

3.2. Reagjentët

- (a) Tolueni.
- (b) Metanoli.



- (c) Acidi sulfurik, me dendësi relative prej 1,84, në temperaturë 20 °C (¹²).
- (d) Sulfati i kaliumit (¹²).
- (e) Dyoksidi i selenit (¹²).
- (f) Tretësira e hidroksidit të natriumit (400 g/litër). Tretni 400gr të hidroksidit të natriumit në 400-500ml ujë dhe holloni me ujë deri në 1 litër.
- (g) Indikatorët e përzier. Tretni 0,1 g të metilit të kuq në 95 ml metanol dhe 5 ml ujë, dhe përzieri këtë tretësirë me 0,5 g te bromkresolit të gjelbër të tretur në 475 ml etanol dhe 25 ml ujë.
- (h) Tretësira e acidit borik. Tretni 20 g të acidit borik në 1 litër ujë.
- (i) Acidi sulfurik, 0,02N (tretësirë standarde vëllimetrike).

4. TRAJTIMI PARAPRAK I MOSTRËS LABORATORIKE

Trajtimi paraprak në vijim është zëvendësuar për trajtimin paraprak të përshkruar në udhëzimet e përgjithshme:

Ekstraktoni mostrën laboratorike të tharë në ajër në aparaturën Soxhlet me një përzierje të 1 vëllimi të toluenit dhe tri vëllimeve të metanolit për 4 orë, me normë minimale të 5 cikleve për orë. Lejoni tretësin të avullohet nga mostra në ajër, dhe largoni gjurmët e fundit në një furrë 105 ± 3 °C. Pastaj ekstraktoni mostrën në ujë (50 ml ujë për g të mostrës) duke e vluar me gurgullim për 30 minuta. Filtrojeni, largoni ujin e tepërt nga mostra duke e shtrydhur atë, me thithje nën vakum, ose me anë të centrifugimit dhe lëreni mostrën të thahet në ajër.

Shënim:

Duhet të merren parasysh efektet toksike të toluenit dhe metanolit, si dhe duhet të merren masa të plota të kujdesit gjatë përdorimit të tyre.



5. PROCEDURA E TESTIMIT

5.1. Udhëzimet e përgjithshme

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme për sa i përket përzgjedhjes, tharjes dhe peshimit të ekzemplarit/mostrës.

5.2. Procedurat e detajuara

Transferoni mostrën në enën për tretje Kjeldahl. Në mostrën që peshon së paku 1g, e cila ndodhet në enën e tretjes, shtoni, sipas radhitjes në vijim, 2,5g sulfat kaliumi, 0,1-0,2g dyoksid seleni dhe 10 ml acid sulfurik (densiteti relativ i të cilit është 1,84, në temperaturë 20 °C). Nxeheni enën lehtë në fillim, derisa të gjitha fibrat të jenë shkatërruar, pastaj nxeheni më fortë derisa tretja të bëhet e kthjellët dhe pothuajse e pangjyrë. Nxeheni me tej edhe për 15 minuta. Lëreni enën të ftohet, treni përmbajtjen me kujdes me 10-20 ml ujë, ftoheni, transferoni përmbajtjen në sasi të barabarta në një menzurë 200 ml dhe mbusheni me ujë për të formuar tretësirën e tretjes. Vendosni 20 ml të acidit borik në një erlenmayer prej 100 ml dhe vendoseni erlenmajerin nën kondensatorin e aparatit të distilimit Kjeldahl, në mënyrë që gypi i furnizimit të zhytet pak nën sipërfaqen e tretësirës së acidit borik. Transferoni saktësisht 10 ml të tretësit në enën për distilim, shtoni jo më pak se 5 ml tretësirë të hidroksidit të natriumi në hinkë, ngrijeni tapën ngadalë dhe lejoni tretësirën e hidroksidit të natriumi të rrjedh ngadalë në enë. Nëse tretësira e ndarë dhe tretësira e hidroksidit të natriumit mbeten si dy shtresa të ndara, përzini ato me tundje të lehtë. Nxeheni enën për distilim ngadalë dhe kalojeni në avull nga gjeneratori. Merrni rreth 20 ml destilat, uleni erlenmajerin ashtu që maja e gypit furnizues të kondensatorit të jetë rreth 20mm mbi sipërfaqen e lëngut dhe distiloni edhe për 1 minutë më shumë. Shpërlajeni majën e gypit furnizues me ujë, duke kapur pjesën e larë në erlenmayer. Largojeni erlenmajerin dhe zëvendësojeni atë me një erlenmayer tjetër që përmban afërsisht 10 ml të tretësirës së acidit borik dhe merrni rreth 10 ml destilat.

Titulloni dy destilatet veç e veç me acid sulfurik 0,02 N, duke përdorur indikatorin e përzier. Regjistroni pikën e ekuivalente për të dy destilatet. Nëse pika e ekuivalencës së destilatit të dytë është më e madhe se 0,2 ml, përsëritni testin dhe filloni distilimin përsëri duke përdorur një alikuotë/sasi të njëjtë të tretësit.

Zhvillo në të njëjtën kohë edhe një test referent/mostër referente d.m.th. tretja dhe distilimi i kryer duke përdorur vetëm reagjentë, pa mostër.



6. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

6.1. Llogarit përqindjen e përmbajtjes së azotit në mostrën e tharë si në vijim:

$$A\% = \frac{28 (V - b) N}{W}$$

ku,

A = përqindja e azotit në mostër të pastër dhe të thatë,

V = vëllimi i përgjithshëm, në ml të acidit sulfurik standard, që përdoret për përcaktim të mostrës,

b = vëllimi i përgjithshëm, në ml të acidit sulfurik standard, që përdoret për përcaktim të mostrës referente,

N = normalitet i acidit sulfurik standard,

W = masa e thatë (g) e mostrës.

6.2. Duke përdorur vlerat prej 0,22% për përmbajtjen e azotit në jutë dhe 16,2% për përmbajtjen e azotit në fibrat e kafshëve, të dyja përqindjet e shprehura në masën e thatë të fibrës, llogaritni përbërjen e përzierjes, si në vijim:

$$PA\% = \frac{A - 0,22}{16,2 - 0,22} \times 100$$

ku

PA% = përqindja e fibrave të kafshëve në mostër të pastër dhe të thatë.

7. SAKTËSIA

Në një përzierje homogjene të materialeve tekstile, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për një nivel besueshmërie prej 95%.



METODA Nr. 13

FIBRAT POLYPROPYLENE DHE FIBRA TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me Ksilen)

1. FUSHA APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibroze, për përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. fibrave polipropilen (37)
 me
2. lesh (1), qime të kafshëve (2 dhe 3), mëndafsh (4), pambuk (5), acetatë (19), fibra bakri (21), modale (22), triacetate (24), viskozë (25), akril (26), poliamide ose najlon (30), poliestër (35), fibra xhami (44), elastomultiester (45) dhe melaminë (47).

2. PARIMET

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

- (a) Erlenmajeri me kapacitet prej së paku 200 ml.
- (b) Kondensatori i gurgullues (i përshtatshëm për lëngjet me pikë të lartë të vlimit), që montohet në erlenmajer (a).
- (c) Nxehësi laboratorik në pikën e vlimit të ksilenit.

3.2. Reagjenti

Ksileni i distiluar ndërmjet temperaturave prej 137 dhe 142 °C.

Shënim:



Ksileni ndizet lehtë dhe avujt e tij janë toksik. Gjatë përdorimit të tij duhet të ndërmerren masa adekuate të kujdesit.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim:

Në mostrën e cila ndodhet në erlenmajer (3.1(a)), shtoni 100 ml ksilen (3.2) për gram të mostrës. Vendoseni kondensatorin (3.1 (b)), lëreni përmbajtjen të vlojë dhe mbajeni në pikën e vlimit për 3 minuta. Menjëherë kullojeni lëngun e nxehtë nëpër enën për filtrim (shih shënimin 1). Përsëriteni këtë trajtim edhe dy herë tjera, secilën herë duke përdorur porcione prej 50 ml të tretësit të freskët.

Lajini mbetjet e mbetura në erlenmajer vazhdimisht me 30 ml ksilen të nxehtë (dy herë), pastaj me 75 ml benzen (pika I.3.2.1 nga udhëzimet e përgjithshme) (dy herë). Pas larjes së dytë me benzen, filtroni përmbajtjen e erlenmajerit nëpër enën për filtrim, transferoni çdo fibër të mbetur në enën për filtrim me ndihmën e një sasive të vogël të benzenit dhe lejoni tretësin që të avullohet. Thajeni enën për filtrim dhe mbetjet, ftohi ato dhe peshoni.

Shënime:

1. Ena filtruese nëpër të cilën duhet të filtrohet ksileni duhet ngrohur paraprakisht.
2. Pas trajtimit me ksilen të vluar, sigurohuni që erlenmajeri që përmban mbetjet është ftohur mjaftueshëm para se ta aplikoni benzenin.
3. Në mënyrë që të zvogëlohen rreziqet nga toksiciteti dhe zjarri për laborantin, mund të përdoret aparatura e nxehur për ekstraktim duke përdorur procedurat e duhura, të cilat japin rezultate identike ⁽¹³⁾.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e ‘d’ është 1,00, përveç për melaminën, për të cilën ‘d’ është 1,01.

6. SAKTËSIA



Në një përzierje homogjene të materialeve tekstile, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për një nivel besueshmërie prej 95%.

METODA Nr. 14

FIBRA TË CAKTUARA DHE KLOOROFIBRA (HOMOPOLMERE TË KLOORURIT TË VINILIT), ELASTOLEFINA OSE MELAMINA

(Metoda me acid sulfurik të koncentruar)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibrore, për përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. Pambukut (5), acetatit (19), fibra bakri (21), modale (22), triacetate (24), viskozës (25), akrileve të caktuara (26), modakrileve të caktuara (29), poliamideve ose najlonit (30), poliesteri (35) dhe elastomultiester (45)

me

2. Fibra klorure (27) me bazë të homopolimerëve të klorurit të vinilit, qoftë të pas-klorinizuara apo jo, elastolefinë (46) dhe melaminë (47).

Modakrilet në fjalë janë ato të cilat japin një tretësirë të kthjellët kur futet në acid sulfurik të përqendruar (me dendësi relative prej 1,84, në temperaturë 20 ° C).

Kjo metodë mund të përdoret në vend të metodave Nr. 8 dhe Nr. 9.

2. PARIMI

Përbërësit tjetër përveç fibrave klorure, elastolefinë ose melaminë (d.m.th. fibrat e përmendura në pikën 1.1) treten nga një masë e njohur e thatë e përzierjes me acid sulfurik (me dendësia relative prej 1,84, në temperaturë 20 ° C).

Mbetja e përberë nga fibrat klorure, elastolefina dhe melamina, grumbullohet, pastrohet, thahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet në përqindje të masës së thatë të përzierjes. Përqindja e përbërësve të dytë fitohet nga ndryshimi.



3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

- (a) Erlenmajeri me kapacitet prej së paku 200 ml.
- (b) Shkopi i qelqit me fund të rrafshuar.

3.2. Reagjentët

- (a) Acid sulfurik i përqendruar (me dendësi relative prej 1,84, në temperaturë 20 °C).
- (b) Acid sulfurik, tretësirë ujore përafërsisht 50 % (m/m).

Përgatitni duke shtuar me kujdes, duke e ftohur njëkohësisht, 400 ml të acidit sulfurik (me dendësi relative prej 1,84, në 20 °C) në 500 ml ujit të distiluar ose të dejonizuar. Pas ftohjes në temperaturë të dhomës, holloni tretësirën me ujë deri në një litër.

- (c) Amoni, tretësirë e holluar.

Holloni 60 ml të tretësirës së përqendruar të amonit (me dendësi relative prej 0,880, në temperaturë 20 ° C) në një litër ujë të distiluar.

4. PROCEDURA E TESTIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdoni si në vijim:

Në ekzemplarin/mostrën e testimit që ndodhet në enë (3.1(a)) shtoni 100ml të acidit sulfurik (3.2(a)) për gram të mostrës.

Lëreni përmbajtjen në enë të qëndroj në temperaturën e dhomës për 10 minuta dhe gjatë kësaj kohe përzieni mostrën e testimit herë pas here me anë të shkopit të qelqit. Nëse është duke u trajtuar një pëlhurë e thurur ose e endur, mbështeteni mes mureve të enës dhe shkopit të qelqit dhe ushtroni presion të lehtë në mënyrë që të ndahet materiali i tretur nga acidi sulfurik.

Kullojeni lëngun përmes enës së peshuar për filtrim. Shtoni në enë një sasi të freskët prej 100 ml të acidit sulfurik (3.2(a)) dhe përsëritni veprimin e njëjtë. Transferoni përmbajtjen e enës në enë për filtrim dhe transferoni mbetjet e fibrave me ndihmën e shkopit



të qelqit. Nëse është e nevojshme shtoni pak acid sulfurik të përqendruar në enë (3.2(a)) në mënyrë që të largohen fibrat e ngjitura për muri të enës. Thajeni enën për filtrim me thithje nën vakum; largoni filtratin duke e zbrazur ose ndërruar enën filtruese, pastroni mbetjet në enën për filtrim me tretësirë të acidit sulfurik 50% (3.2(b)), me ujë të distiluar ose të dejonizuar (pjesa I.3.2.3 e udhëzimeve të përgjithshme), tretësira amoniakale (3.2(c)) dhe përfundimisht pastroni plotësisht me ujë të distiluar ose dejonizuar, duke e kulluar enën për filtrim me thithje pas secilit shtim të bërë. (Mos aplikoni thithjen nën vakum gjatë veprimit të pastrimit, por vetëm pasi të kullohet lëngu nën veprim të gravitetit). Thajeni enën për filtrim dhe mbetjen, ftohni ato dhe peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e ‘d’ është 1,00, përveç melaminës që ka vlerën e ‘d’ = 1,01.

6. SAKTËSIA

Në një përzierje homogjene të materialeve të tekstilit, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për nivelin e besueshmërisë prej 95%.

METODA Nr. 15

KLOROFIBRAT, MODAKRILE TË CAKTUARA, ELASTANE TË CAKTUARA, FIBRA ACETATE, TRIACETATE DHE FIBRA TË TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me përdorim të cikloheksanit)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibrore, për përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. Acetatë (19), triacetate (24), fibra klorure (27), modakrile të caktuara (29), elastane të caktuara (43)

me

2. Lesh (1), qime kafshësh (2 dhe 3), mëndafsh (4), pambuk (5), fibra bakri (21), modal (22), viskozë (25), poliamide apo najlon (30), akril (26), fibër qelqi (44) dhe melaminë (47).



Kur janë pranishme modakrilet ose elastanet, së pari duhet të kryhet një test paraprak për të përcaktuar nëse fibra është tërësisht e tretshme në reagjent.

Gjithashtu është e mundur që të analizohen përzierjet që përmbajnë fibra klorure duke përdorur metodën Nr. 9 ose 14.

2. PARIMI

Fibrat acetat dhe triacetate, fibrat klorure, modakrilet dhe elastanet e caktuara treten nga një masë e njohur e thatë me cikloheksan, në temperaturë afër pikës së vlimit. Mbetja grumbullohet, lahet, thahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet si përqindje e masës së thatë të përzierjes. Përqindja e fibrës klorure, modakrilike, elastane, acetat dhe triacetate fitohet nga ndryshimi.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuar në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. Aparatura

- (a) Aparatura për ekstraktim të nxehtë, e përshtatshme për përdorim në procedurën e testimit në pikën 4 (shih figurën: ky është një variant i aparaturës së përshkruar në Melliand Textilberichte 56 (1975) faqe. 643-645).
- (b) Ena e filtrimit që përmban ekzemplar/mostrën e testimit.
- (c) Shtresa poroze (me nivel të porozitetit 1).
- (d) Kondensator gurgullues, që mund të përshtatet në enën laboratorike të distilimit.
- (e) Pajisja për ngrohje.

3.2. Reagjentët

- (a) Cikloheksani, pika e vlimit 156 °C.
- (b) Alkool etilik 50 % sipas vëllimit.



Shënim:

Cikloheksani është lehtë i ndezshëm dhe toksik. Gjatë përdorimit të tij duhet të merren masa të duhura mbrojtëse.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqui procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe pastaj vazhdoni si në vijim:

Derdhni në enën/balonin e distilimit 100 ml cikloheksan për gram të materialit, vendosni enën e ekstraktimit në të cilën ndodhet ena për filtrim që përmban mostrën dhe shtresën poroze, të ngritur paksa, e të cilat janë vendosur më parë. Vendosni kondensatorin e gurgullimit. Vlojeni dhe të vazhdoni ekstraktimin për 60 minuta në një normë minimale prej 12 cikleve në orë.

Pas ekstraktimit dhe ftohjes, largoni enën e ekstraktimit, nxirrni enën për filtrim dhe largoni shtresën poroze. Lani përmbajtjen e enës së filtrimit, tre ose katër herë me alkool etilik 50%, të nxehur deri në rreth 60 °C, dhe pastaj me 1 litër ujë në temperaturë 60 °C.

Mos aplikoni thithjen nën vakum, gjatë ose ndërmjet procedurës së pastrimit. Lejoni që lëngu të kullohet nën gravitet dhe pastaj aplikoni thithjen nën vakum.

Në fund, thani enën për filtrim me mbetjet, ftoheni atë dhe peshoni.


5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,00, përveç në rastin e mëndafshit dhe melaminës, për të cilat 'd' = 1,01, dhe për akrilin që ka vlerën e 'd' = 0,98.

6. SAKTËSIA

Në përzierjet homogjene të fibrave të tekstilit, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 1 për nivelin e besueshmërisë prej 95 %.

Figura e përmendur në pikën 3.1 (a) e metodës Nr. 15





METODA Nr. 16

MELAMINA DHE FIBRAT TJERA

(Metoda me përdorim të acidit formik të nxehtë)

1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibroze, për përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. melamina (47)
me
2. pambuk (5) dhe fibër aramid (31).

2. PARIMI

Melamina tretet nga masa e thatë e përzierjes me acid formik të nxehtë (90 % m/m).

Mbetja grumbullohet, lahet, thahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet si përqindje e masës së thatë të përzierjes. Përqindja e përbërësve të dytë fitohet nga ndryshimi.

Shënim:

Mbani në mënyrë rigoroze temperaturën e rekomanduar për shkak se tretshmëria e melaminës varet shumë nga temperatura.

3. APARATURA DHE REAGJENTËT (përveç atyre të specifikuara në udhëzimet e përgjithshme)

3.1. APARATURA

- (a) Erlenmajeri me kapacitet prej të paktën 200 ml.
- (b) Banjë uji luhatëse ose ndonjë aparaturë tjetër për të lëkundur dhe ruajtur temperaturën e enës laboratorike në temperaturën prej 90 ± 2 °C.



3.2. Reagentët

(a) Acidi formik (90 % m/m, me densitet relativ prej 1,204, në temp. 20 °C). Holloni 890 ml të acidit formik me pastërti/përqendrim nga 98 deri në 100 % m/m (me densitet relativ prej 1,220, në temperaturë 20 °C) në 1 litër ujë.

Acidi formik i nxehtë është shumë korroziv dhe duhet të përdoret me kujdes të shtuar.

(b) Tretësira e amoniakut të holluar: holloni 80 ml të tretësirës amoniakale të përqendruar (me dendësi relative prej 0,880, në temperaturë 20 °C) në 1 litër ujë.

4. PROCEDURA E TESTIMIT

Ndiqu procedurën e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme, pastaj vazhdoni si në vijim:

Në ekzemplarin/mostrën për testim që gjendet në erlenmajer me kapacitet prej 200 ml, shtoni 100 ml acid formik për gram të mostrës. Vendosni tapën dhe tundeni enën për të lagur mostrën. Mbajeni erlenmajerin për 1 orë në banjën lëkundëse me ujë në temp. 90 ± 2 °C, duke e tundur atë fuqishëm. Ftoheni erlenmajerin deri në temperaturën e dhomës. Kulloni lëngun nëpër enën e matur për filtrim.

Shtoni 50 ml të acidit formik në enën që përmban mbetjen, tundeni me dorë dhe filtroni përmbajtjen që gjendet në erlenmajer nëpër enën për filtrim. Transferoni fibrat e mbetura në enës për filtrim duke shpërlarë erlenmajerin pak më shumë me reagent të acid formik. Kulloni enës për filtrim me thithje nën vakum, si dhe pastroni mbetjet me reagent të acid formik, me ujë të ngrohtë, me tretësirë amoniakale, dhe në fund me ujë të ftohtë duke kulluar enën për filtrim me thithje pas çdo shtimi. Mos aplikoni thithjen nën vakum derisa i tërë lëngu shpëlarës të mos rrjedhë nën gravitetit. Në fund, kulloni enën për filtrim me anë të thithjes nën vakum, thani enën për filtrim dhe mbetjen, pastaj ftoheni atë dhe peshoni.

5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Llogaritni rezultatet siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e 'd' është 1,02.

6. SAKTËSIA



Në përzierjet homogjene të materialeve të tekstilit, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të fituara nga kjo metodë nuk janë më të mëdha se ± 2 për nivelin e besueshmërisë prej 95 %.

KAPITULLI 3

ANALIZA SASIORE E PËRZIERJEVE TË FIBRAVE TREFISHE TË TEKSTILIT

HYRJE

Në përgjithësi, metodat e analizave kimike sasiore bazohen në zgjidhjen e komponentëve individual. Janë katër variante të mundshme të kësaj metode:

1. Përdorimi i dy mostrave të ndryshme për testim, ku njëri komponent (a) tretet nga ekzemplari/mostra e parë për testim, dhe tjetri komponent (b) nga ekzemplari/mostra e dytë për testim. Mbetjet e patretshme të secilës mostër maten, dhe përqindja e secilit komponent të tretshëm llogaritet nga humbjet përkatëse në masë. Përqindja e komponentit të tretë (c) llogaritet nga ndryshimi.
2. Përdorimi i dy mostrave të ndryshme për testim, ku njëri komponent (a) tretet nga ekzemplari/mostra e parë e testimit dhe dy komponentët tjerë (a dhe b) nga ekzemplari/mostra e dytë e testimit. Mbetja e patretshme e mostrës së parë të testit matet dhe përqindja e komponentit (a) llogaritet nga humbja në masë. Mbetja e patretshme e mostrës së dytë për testim matet; nëse korrespondon me komponent (c). Përqindja e komponentit të tretë (b) llogaritet nga ndryshimi.
3. Përdorimi i dy mostrave të ndryshme për testim, ku dy komponentë (a dhe b) treten nga mostra e parë e testimit, si dhe dy komponentë (b dhe c) nga mostra e dytë e testimit. Mbetjet e patretshme korrespondojnë me dy komponentë (c) dhe (a). Përqindja e komponentit të tretë (b) llogaritet nga ndryshimi.
4. Përdorimi i vetëm i një mostre për testim, pas largimit të një prej komponentëve, matet mbetja e patretshme e formuar nga dy fibra të tjerë, si dhe përqindja e komponentit të tretshëm llogaritet nga humbja në masë. Një nga dy fibrat e mbetjes tretet, matet komponenti i patretshëm dhe përqindja e komponentit të dytë të tretshëm llogaritet nga humbja në masë.



Kur ekziston zgjedhje, këshillohet përdorimi i njërit prej tre varianteve të para.

Kur përdoret analiza kimike, eksperti që është përgjegjës për analiza duhet të kujdeset që të përzgjedhë metodat që përfshijnë tretës që treshin vetëm fibrat e duhura, duke lënë të pa prekura fibrat tjera.

Si shembull, në Seksionin V është dhënë një tabelë e cila përmban një numër të caktuar të përzierjeve të fibrave trefishe, së bashku me metodat për analizimin e përzierjeve të fibrave dyfishe të cilat mund të përdoren në analizimin e këtyre përzierjeve të fibrave trefishe.

Në mënyrë që të zvogëlohet në minimum mundësia e gabimit, rekomandohet që kur është e mundur të bëhet analiza kimike duke përdorur të paktën dy nga katër variantet e mësipërme.

Para se të vazhdojmë me ndonjë analizë, duhet të identifikohen të gjitha fibrat e pranishme në përzierje. Në disa metoda kimike, përbërësi i patretshëm i një përzierje mund të tretet pjesërisht në reagjentin e përdorur për të tretur përbërësit e tretshëm. Kudo që ka qenë e mundur, janë zgjedhur reagjentët të cilët kanë pak ose aspak ndikim në fibrat e patretshme. Nëse gjatë analizës paraqitet ndonjë humbje në masë, rezultati korrigjohet nga faktorët për korrigjim të cilët janë dhënë për këtë qëllim. Këta faktorë janë përcaktuar në disa laboratorë duke trajtuar fibrat e pastruara me trajtim paraprak me reagjent të duhur, siç specifikohet në metodën e analizës. Këta faktorë për korrigjim aplikohen vetëm për fibrat e nën-klasifikuar dhe nëse fibrat janë degraduar para ose gjatë përpunimit atëherë faktorët e ndryshëm korrigjues mund të jenë të nevojshëm. Nëse varianti i katërt, në të cilin një fibër i tekstilit i nënshtrohet veprimit të njëpasnjëshëm të dy tretësve të ndryshëm, atëherë faktorët e korrigjimit duhet të aplikohen për humbjet e mundshme të masës së nënshtuar nga fibra në dy trajtimet. Duhet të bëhen të paktën dy përcaktime, si në rastin e ndarjes manuale dhe në rastin e ndarjes kimike.

I. Informacionet e përgjithshme mbi metodat për analizën kimike sasiore të përzierjeve të fibrave trefishe

Informacionet e përbashkëta me metodat e dhëna për analizën kimike sasiore të përzierjeve të fibrave trefishe.

I.1. FUSHA E APLIKIMIT

Fusha e aplikimit të secilës metodë për analizimin e përzierjeve të fibrave dyfishe specifikon se për cilat fibra është e aplikueshme metoda (shih Kapitullin 2 në lidhje me metodat për analizën sasiore të përzierjeve të caktuara të fibrave dyfishe të tekstilit).

I.2. PARIMI



Pas identifikimit të përbërësve të një përzierje, materiali jo-fibror largohet me anë të trajtimit të përshtatshëm paraprak dhe pastaj aplikohet njëra ose më shumë nga katër variantet e procesit të zgjedhjes selektive të përshkruara në hyrje. Përveç kur kjo paraqet vështirësi teknike, preferohet që të tretet komponenti kryesorë i fibrës, ashtu që të fitohet komponenti i vogël i fibrës si mbetje finale.

I. 3. MATERIALET DHE PAJISJET

I.3.1. Aparatura

I.3.1.1. Enët për filtrim dhe shishet për peshim, mjaftueshëm të mëdha për të përmbajtur enët e tilla të filtrimit, apo ndonjë aparaturë tjetër që jep rezultate identike.

I.3.1.2. Ena laboratorike me vakum.

I.3.1.3. Eksikatori që përmban silikagel vetë tregues.

I.3.1.4. Furrë e ventiluar për tharjen e mostrave në temperaturë 105 ± 3 °C.

I.3.1.5. Peshore analitike, me saktësi prej 0,0002 g.

I.3.1.6. Ekstraktuesi "Soxhlet" ose aparatura tjera që japin rezultate identike.

I.3.2. Reagjentët

I.3.2.1. Benzeni, i re-distiluar, me shkallë të vlimit 40 deri në 60 °C

I.3.2.2. Reagjentët tjerë specifikohen në seksionet përkatëse të secilës metodë.

I.3.2.3. Ujë i distiluar ose i dejonizuar.

I.3.2.4. Aceton.

I.3.2.5. Acid ortofosforik.

I.3.2.6. Ure.



I.3.2.7. Bikarbonat natriumi.

Të gjithë reagjentët e përdorur duhet të jenë kimikisht të pastër.

I. 4. PËRSHTATJA DHE RREGULLIMI I ATMOSFERËS PËR TESTIM

Për shkak se masat e thata janë të përcaktuara, është e panevojshme që t'i rregullohet gjendja e ekzemplarit/mostrës ose të kryhen analizat në një atmosferë të kondicionuar.

I. 5. MOSTRA LABORATORIKE

Merrni një mostër laboratorike që është përfaqësuese e mostrës së përgjithshme laboratorike, dhe e mjaftueshme për të siguruar të gjithë ekzemplarët e nevojshëm, secili prej tyre prej të paktën 1 g.

I. 6. TRAJTIMI PARAPRAK I MOSTRËS LABORATORIKE ⁽¹⁴⁾

Kur është e pranishme një substancë që nuk duhet të merret parasysh në llogaritjet e përqindjes (shih nenin 19), së pari duhet të largohet me një metodë të përshtatshme që nuk ka ndikim në ndonjërin prej përbërësve të fibrës. Për këtë qëllim, materia jo-fibrore që mund të ekstraktohet me benzen dhe ujë largohet duke e trajtuar për 1 orë mostrën laboratorike në ekstraktuesin "Soxhlet" me anë të benzenit, në një normë minimale prej gjashtë ciklesh në orë. Lejo benzenin që të avullohet nga mostra laboratorike, e cila më pas ekstraktohet me anë të trajtimit të drejtpërdrejtë, që përfshinë zhytjen e mostrës laboratorike në ujë për 1 orë, në temperaturën e dhomës dhe më pas zhytje në ujë në temperaturë 65 ± 5 °C për një orë tjetër, duke e tundur lëngun kohë pas kohe. Përdorni një raport lëng:mostër laboratorike prej 100:1. Largoni ujin e tepërt nga mostra laboratorike, duke e shtrydhur, me anë të thithjes nën vakum apo përmes centrifugës dhe pastaj lëreni mostrën laboratorike të thahet përmes ajrimit.

Në rastin e elastolefinës apo përzierjeve të fibrave që përmbajnë elastolefinë dhe fibra të tjera (lesh, qime të kafshëve, mëndafsh, pambuk, fije liri (ose linë), kërp, jutë, abakë (kërp Manile), alfa (esparto), Coir (arrë e kokosit), fshesëz, rami, Sisali, kupro (fije bakri), modale, proteina, fije mëndafshi, akril, poliamide ose najlon, poliester, elastomultiester) procedura e posa përshkruar do të modifikohet, në fakt eteri i naftës së holluar do të zëvendësohet me acetone.

Kur materia jo-fibrore nuk mund të ekstraktohet me benzen dhe ujë, largohet duke e zëvendësuar nga metoda e ujit, të përshkruar më lart, me një metodë të përshtatshme që nuk ndryshon në thelb ndonjërin prej përbërësve të fibrës. Megjithatë, për disa fibra të



pazbardhura, natyrore bimore (p.sh juta, Coir (mbështjellësi i arrës së kokosit), duhet të theksohet se trajtimi paraprak normal me benzen dhe ujë nuk do të largoj të gjitha substancat natyrore jo-fibrore; megjithatë trajtimi paraprak shtesë nuk aplikohet nëse mostra përmban mbetje të patretshme në benzen dhe ujë.

Raportet e analizës përfshijnë detaje të plota të metodave të përdorura nga trajtimi paraprak.

I.7. PROCEDURA E TESTIMIT

I.7.1. Udhëzimet e përgjithshme

I.7.1.1. Tharja

Kryeni të gjitha veprimet e tharjes për jo më pak se 4 orë dhe jo më shumë se 16 orë në temp. 105 ± 3 °C në një furrë të venteluar me derën e furrës të mbyllur mirë. Nëse periudha e tharjes është më shkurtër se 14 orë, pesha e mostrës duhet të kontrollohet për të përcaktuar nëse masa e saj është konstante. Masa mund të konsiderohet si konstante në qoftë se, pas një periudhe të mëtejshme të tharjes prej 60 minutash, ndryshimi i saj është më i vogël se 0,05%.

Shmangni kapjen e enës për filtrim, shisheve për peshim, mostrave ose mbetjeve pa dorëza mbrojtëse gjatë proceseve të tharjes, ftohjes dhe peshimit.

Thani ekzemplarët/mostrat në një shishe për peshim me kapakun e saj pranë. Pas tharjes, mbylleni shishen për peshim para se ta zhvendosni atë nga furra, dhe transferojeni shpejtë në eksikatorë.

Thani enën për filtrim në furrë, në një shishe për peshim me kapakun e saj pranë. Pas tharjes, mbyllni shishen për peshim dhe transferojeni shpejtë në eksikatorë.

Kur përdoren aparatura tjera përveç enës për filtrim, veprimet e tharjes kryhen në furrë për të përcaktuar masën e thatë të fibrave pa humbje.

I.7.1.2. Ftohja



Kryeni të gjitha veprimet e ftohjes në eksikatorë, të vendosur pranë peshores, deri sa ftohja e shisheve për peshim të jetë e plotë, dhe në çdo rast për jo më pak se 2 orë.

I.7.1.3. Peshimi

Pas ftohjes, kryeni peshimin e shishes për peshim brenda 2 minutash pas largimit të tyre nga eksikator; peshimi duhet të bëhet me saktësi prej 0,0002 g.

I.7.2. Procedura

Merrni një ekzemplarë prej të paktën 1 g (në masë) nga mostra laboratorike e trajtuar paraprakisht. Preni fillin apo pëlhurën në gjatësi prej rreth 10mm, të prerë në sa më shumë pjesë të imta. Thani ekzemplarë në një shishe për peshim, ftoheni në eksikatorë dhe pastaj peshojeni (matni) atë. Transferoni mostrën në enën prej qelqi të specifikuar në seksionin përkatës të metodës së Unionit, ri-peshoni shishen për peshim menjëherë dhe përfitoni masën e thatë të mostrës nga ndryshimi; përfundoni testimin siç specifikohet në seksionin përkatës të metodës së aplikueshme. Ekzaminoni mbetjet me mikroskop, për të kontrolluar nëse trajtimi ka larguar tërësisht fibrën-at e tretshme.

I. 8. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Shprehni masën e secilit komponent si përqindje e masës së përgjithshme të fibrave në përzierje. Llogaritni rezultatet mbi bazën e masës së pastër e të thatë, të rregulluar sipas (a) lejimeve të dakorduara dhe (b) faktorëve të korrigjimit, të nevojshëm për të marrë parasysh humbjen e materies jo-fibrore gjatë trajtimit paraprak dhe analizës.

I.8.1. Llogaritja e përqindjeve të masës së fibrave të pastra e të thata duke shpërfillur humbjen e masës së fibrave gjatë trajtimit paraprak.

I.8.1.1. - VARIANTI 1 -

Formulat që duhet të aplikohen kur një komponent i përzierjes largohet nga njëri ekzemplarë/mostër dhe një komponent tjetër nga ekzemplari/mostra e dytë:



$$P_1\% = \left[\frac{d_2}{d_1} - d_2 \times \frac{r_1}{m_1} + \frac{r_2}{m_2} \times \left(1 - \frac{d_2}{d_1} \right) \right] \times 100$$

$$P_2\% = \left[\frac{d_4}{d_3} - d_4 \times \frac{r_2}{m_2} + \frac{r_1}{m_1} \times \left(1 - \frac{d_4}{d_3} \right) \right] \times 100$$

$$P_3\% = 100 - (P_1\% + P_2\%)$$

ku,

$P_1\%$ është përqindja e komponentit të parë të pastër të thatë (komponenti në mostrën e parë të tretur në reagjentin e parë),

$P_2\%$ është përqindja e komponentit të dytë të pastër të thatë (komponenti në mostrën e dytë të tretur në reagjentin e dytë),

$P_3\%$ është përqindja e komponentit të tretë të pastër të thatë (komponenti i patretur në të dyja mostrat),

m_1 është masa e thatë e mostrës së parë pas trajtimit paraprak,

m_2 është masa e thatë e mostrës së dytë pas trajtimit paraprak,

r_1 është masa e thatë e mbetjes pas largimit të komponentit të parë nga mostra e parë në reagjentin e parë,

r_2 është masa e thatë e mbetjes pas largimit të komponentit të dytë nga mostra e dytë në reagjentin e dytë,

d_1 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e parë, të komponentit të dytë të patretur në mostrën e parë ⁽¹⁵⁾;

d_2 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e parë, të komponentit të tretë të patretur në mostrën e parë,

d_3 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e dytë, të komponentit të parë të patretur në mostrën e dytë,

d_4 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e dytë, të komponentit të tretë të patretur në mostrën e dytë.



I.8.1.2. - VARIANTI 2 -

Formulat që duhet të zbatohen kur komponenti (a) është larguar nga mostra e parë, duke lënë si mbetje dy përbërësit e tjerë (b + c), si dhe dy komponentët (a + b) janë larguar nga mostra e dytë, duke lënë si mbetje komponentin e tretë (c):

$$P_1\% = 100 - (P_2\% + P_3\%)$$

$$P_2\% = 100 \times \frac{d_1 r_1}{m_1} - \frac{d_1}{d_2} \times P_3\%$$

$$P_3\% = \frac{d_4 r_2}{m_2} \times 100$$

$P_1\%$ është përqindja e komponentit të parë, të pastër dhe të thatë (komponenti në mostrën e parë të tretur në reagjentin e parë),

$P_2\%$ është përqindja e komponentit të dytë, të pastër dhe të thatë (komponenti i tretshëm, në të njëjtën kohë, si komponenti i parë i modelit të dytë, në reagjentin e dytë),

$P_3\%$ është përqindja e komponentit të tretë që është i pastër dhe i thatë (komponenti i patretshëm në të dy mostrat),

m_1 është masa e thatë e mostrës së parë pas trajtimit paraprak,

m_2 është masa e thatë e mostrës së dytë pas trajtimit paraprak,

r_1 është masa e thatë nga mbetja pas heqjes së komponentit të parë nga mostra e parë në reagjentin e parë,

r_2 është masa e thatë nga mbetja pas heqjes së përbërësve të parë dhe të dytë nga mostra e dytë në reagjentin e dytë,

d_1 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e parë të komponentit të dytë të patretur në mostrën e parë,

d_2 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e parë, të komponentit të tretë që nuk është tretur në mostrën e parë,

d_4 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e dytë, të komponentit të tretë që nuk është tretur në mostrën e dytë.



I.8.1.3. - VARIANTI 3 -

Formulat që duhet të zbatohen kur dy komponentë (a + b) largohen nga një mostër, duke lënë si mbetje komponentin e tretë (c), pastaj dy komponent (b + c) largohen nga një tjetër mostër, duke e lënë si mbetje komponentin e parë (a):

$$P_1\% = \frac{d_3 r_2}{m_2} \times 100$$

$$P_2\% = 100 - (P_1\% + P_3\%)$$

$$P_3\% = \frac{d_2 r_1}{m_1} \times 100$$

$P_1\%$ është përqindja e komponentit të parë të pastër dhe të thatë (komponenti i tretur nga reagjenti),

$P_2\%$ është përqindja e komponentit të dytë të pastër dhe të thatë (komponenti i tretur nga reagjenti),

$P_3\%$ është përqindja e komponentit të tretë të pastër dhe të thatë (komponenti i tretur në mostrën e dytë nga reagjenti),

m_1 është masa e thatë e mostrës së parë pas trajtimit paraprak,

m_2 është masa e thatë e mostrës së dytë pas trajtimit paraprak,

r_1 është masa e thatë nga mbetja pas largimit të komponentëve të parë dhe të dytë nga mostra e parë me reagjentin e parë,

r_2 është masa e thatë nga mbetja pas largimit të komponentëve të dytë dhe të tretë nga mostra e dytë me reagjentin e dytë,

d_2 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e parë të komponentit të tretë që nuk është tretur në mostrën e parë,

d_3 është faktori korrigjues për humbjen në masë në reagjentin e dytë të komponentit të parë që nuk është tretur në mostrën e dytë.



I.8.1.4. - VARIANTI 4 -

Formulat që duhet të zbatohen kur dy komponentët janë larguar një pas një nga përzierja duke përdorur të njëjtën mostër:

$$P_1\% = 100 - (P_2\% + P_3\%)$$

$$P_2\% = \frac{d_1 r_1}{m} \times 100 - \frac{d_1}{d_2} \times P_3\%$$

$$P_3\% = \frac{d_3 r_2}{m} \times 100$$

$P_1\%$ është përqindja e komponentit të parë të pastër dhe të thatë (komponenti i parë i tretshëm),

$P_2\%$ është përqindja e komponentit të dytë të pastër dhe të thatë (komponenti i dytë i tretshëm),

$P_3\%$ është përqindja e komponentit të tretë që është i pastër dhe i thatë (komponent i patretshëm),

m është masa e thatë e mostrës pas trajtimit paraprak,

r_1 është masa e thatë nga mbetja pas eliminimit të komponentit të parë nga reagjenti i parë,

r_2 është masa e thatë nga mbetja, pas eliminimit të komponentit të parë dhe dytë nga reagjentët e parë dhe dytë,

d_1 është faktori korrigjues për humbjen në masë të komponentit të dytë në reagjentin e parë,

d_2 është faktori korrigjues për humbjen në masë të komponentit të tretë në reagjentin e parë,

d_3 është faktori korrigjues për humbjen në masë të komponentit të tretë në reagjentët e parë dhe të dytë ⁽¹⁶⁾.

I.8.2. Llogaritja e përqindjes së secilit komponent me rregullim sipas lejimeve të dakorduara dhe kur është e përshtatshme, faktorët korrigjues për humbjet në masë gjatë veprimeve të trajtimit paraprak:



Nëse:

$$A = 1 + \frac{a_1 + b_1}{100} \quad B = 1 + \frac{a_2 + b_2}{100} \quad C = 1 + \frac{a_3 + b_3}{100}$$

atëherë:

$$P_1A\% = \frac{P_1A}{P_1A + P_2B + P_3C} \times 100$$

$$P_2A\% = \frac{P_2B}{P_1A + P_2B + P_3C} \times 100$$

$$P_3A\% = \frac{P_3C}{P_1A + P_2B + P_3C} \times 100$$

$P_1A\%$ është përqindja e komponentit të parë që është i pastër dhe i thatë, duke përfshirë përmbajtjen e lagështisë dhe humbjen në masë gjatë trajtimit paraprak,

$P_2A\%$ është përqindja e komponentit të dytë të pastër dhe të thatë, duke përfshirë përmbajtjen e lagështisë dhe humbjen në masë gjatë trajtimit paraprak,

$P_3A\%$ është përqindja e komponentit të tretë të pastër dhe të thatë, duke përfshirë përmbajtjen e lagështisë dhe humbjen në masë gjatë trajtimit paraprak,

P_1 është përqindja e komponentit të parë të pastër dhe të thatë, të fituar prej njërës nga formulat e dhëna në I.8.1,

P_2 është përqindja e komponentit të dytë të pastër dhe të thatë, të fituar prej njërës nga formulat e dhëna në I.8.1,

P_3 është përqindja e komponentit të tretë të pastër dhe të thatë, të fituar prej njërës nga formulat e dhëna në I.8.1,

a_1 është lejimi i dakorduar i komponentit të parë,



- a₂ është lejimi i dakorduar i komponentit të dytë,
- a₃ është lejimi i dakorduar i komponentit të tretë,
- b₁ është përqindja e humbjes në masë e komponentit të parë gjatë trajtimit paraprak,
- b₂ është përqindja e humbjes në masë e komponentit të dytë gjatë trajtimit paraprak,
- b₃ është përqindja e humbjes në masë e komponentit të tretë, gjatë trajtimit paraprak.

Kur përdoret një trajtim paraprak i veçantë, atëherë duhet të përcaktohen vlerat b₁, b₂ dhe b₃, nëse është e mundur, duke paraqitur secilin prej përbërësve të fibrës së pastër për trajtimin paraprak të aplikuar në analizë. Fibrat e pastra janë ato të cilat janë të lira nga të gjitha materialet jo-fibrore, përveç atyre që ato zakonisht i përmbajnë (qoftë në mënyrë natyrale ose për shkak të procesit të prodhimit), në gjendjen (të pazbardhura, të zbardhura) në të cilën janë gjetur në materialin që do të analizohet.

Kur nuk janë në dispozicion fibrat e veçanta të pastra, të përdorur në prodhimin e materialit që do të analizohet, atëherë duhet të përdoren vlerat mesatare të b₁, b₂ dhe b₃, ashtu si të fituara nga testet e kryera në fibrat e pastra, të ngjashme me ato në përzierjen e cila ekzaminohet.

Nëse aplikohet trajtimi paraprak normal i ekstraktimit me anë të benzenit dhe ujit, atëherë faktorët korrigjues b₁, b₂ dhe b₃ në përgjithësi mund të injorohen, përveç në rastin e pambukut të pazbardhur, lirit të pazbardhur dhe kërpit të pazbardhur, aty ku humbja për shkak të trajtimit paraprak pranohet zakonisht si 4% dhe në rastin e polipropilenit si 1%.

Në rastin e fibrave të tjerë, humbjet për shkak të trajtimit paraprak zakonisht nuk merren parasysh në llogaritje.

I.8.3. Shënim:

Shembuj të llogaritjes janë dhënë në Seksionin IV.

II. Metoda e analizës sasiore me anë të ndarjes manuale të përzierjeve të fibrave trefishe



II. 1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme për të gjitha llojet fibrave të tekstilit, me kusht që nuk formojnë një përzierje të ngushtë dhe që mund të ndahen me dorë.

II. 2. PARIMI

Pas identifikimit të komponentëve të tekstilit, materia jo-fibrore largohet nga një trajtim i përshtatshëm paraprak dhe më pas fibrat ndahen me dorë, thahen dhe peshohen në mënyrë që të llogaritet përqindja e secilës fibër në përzierje.

II. 3. APARATURA

- II.3.1. Enët për peshim ose aparatura tjera që japin rezultate identike.
- II.3.2. Eksikatori i cili përmban silikagel vetë-tregues.
- II.3.3. Furrë e ventiluar për tharje të mostrave në temperaturë prej 105 ± 3 °C.
- II.3.4. Peshore analitike, e saktësisë 0,0002 g.
- II.3.5. Ekstraktues “Soxhlet”, ose aparatura tjera që japin rezultate identike.
- II.3.6. Gjilpërë.
- II.3.7. Aparati për testimin e përdredhjes apo ndonjë aparat tjetër i ngjashëm.

II. 4. REAGJENTËT

- II.4.1. Benzeni, i re-distiluar, me shkallë të vlimit nga 40 deri në 60 °C.
- II.4.2. Ujë i distiluar ose i dejonizuar.

II. 5. PËRSHTATJA DHE RREGULLIMI I ATMOSFERËS PËR TESTIM

Shih I. 4.



II. 6. MOSTRA LABORATORIKE

Shih I. 5.

II. 7. TRAJTIMI PARAPRAK I MOSTRAVE LABORATORIKE

Shih I. 6.

II. 8. PROCEDURA

II.8.1 Analiza e fijeve

Merrni nga mostra laboratorike e trajtuar paraprakisht një ekzemplarë me masë jo më pak se 1g. Për fijet shumë të holla, analiza mund të bëhet në një gjatësi minimale prej 30m, çfarëdo që të jetë masa e saj.

Preni fijen në copëza me gjatësi të përshtatshme dhe ndani llojet e fibrave me anë të një gjilpëre, dhe nëse është e nevojshme, me një testues të përdredhjes. Llojet e fibrave të fituara vendosen në enët për peshim, të peshuara paraprakisht dhe të thara në temp. 105 ± 3 °C deri në masën konstante, siç përshkruhet në pikat I.7.1 dhe I.7.2.

II.8.2. Analiza e pëlhurës

